



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 7

6 shkurt

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7931 datë 23.1.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	153
Vendim i KM nr. 54, datë 23.1.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të Rafinerisë së Naftës Cërrik dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	154
Udhëzim i MSH, MF nr. 2, datë 15.1.2013	Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave.....	154
Vendim i BSH nr.1, datë 17.1.2013	Për miratimin e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”	165
Vendim i BSH nr. 2, datë 17.1.2013	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”	192
Vendim i BSH nr. 3, datë 17.1.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për instrumentet e pagesave elektronike”	206
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Armand Koxhaj	209

DEKRET
Nr.7931, datë 23.1.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Nadire Jakup Jakupi
2. Vitore Milan Saraçi
3. Astrit Telha Zoto
4. Levend Alush Alushi
5. Thoma Levend Alushi
6. Petref Alush Alushi
7. Shpresa Arif Alushi
8. Vasil Levend Alushi
9. Teuta Levend Alushi
10. Nuri Sinan Alushi
11. Besnik Nuri Alushi
12. Klodian Arif Alushi
13. Bujar Alush Alushi
14. Kimete Ramadan Bylykbashi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



VENDIM
Nr. 54, datë 23.1.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË RAFINERISË SË NAFTËS CËRRIK DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit e Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “ROT” (reabilitim, operim dhe transferim), të Rafinerisë së Naftës Cërrik është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 3 (tre) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të Rafinerisë së Naftës Cërrik, që i jepet konsorciumit të shoqërive “DAST” sh.a., Durrës, “DELTA” sh.a., Durrës dhe “S.T.N.P.M” sh.p.k., Tiranë.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 2, datë 15.1.2013

**MBI PROCEDURAT E PRODHIMIT, KODIMIT, STAMPIMIT, SHPËRNDARJES DHE
MONITORIMIT TË PULLAVE TË KONTROLLIT TË BARNAVE**

Në zbatim të ligjit nr. 10 381, datë 24.2.2011 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoritet kontraktues dhe shoqërive “Sicpa Security Solutions S.A.” e “Sicpa Security Solutions Albania sh.p.k.”, për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, si dhe pikës 9 të nenit 20 të ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në RSH”, të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ministri i Shëndetësisë

UDHËZOJNË:

1. Qëllimi
 - 1.1 Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë modalitetet mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes e monitorimit të pullave të kontrollit, për të gjitha barnat që prodhohen në vend me destinacion tregun shqiptar, si dhe barnat që importohen nga jashtë me destinacion tregun vendas.
 - 1.2 Ky udhëzim përcakton kushtet, afatet, kriteret dhe procedurat që duhet të plotësohen dhe ndiqen për porositjen, miratimin, faturimin, pagesën, çmimin, shpërndarjen, aplikimin dhe monitorimin e pullave të kontrollit të barnave.

1.3 Aplikimi i pullës së kontrollit të barnave bën të mundur identifikimin e sasisë së barnave, përmirëson sigurinë dhe autenticitetin e barnave në interes të përdoruesve të tyre, synon të bëjë të mundur gjurmimin e barnave në të gjithë vendin, në mënyrë që të identifikojë origjinën dhe ligjshmërinë e tyre, si dhe të eliminojë prodhimet e kundërligjshme, sikurse prodhimin dhe tregtimin e barnave të falsifikuara.

1.4 Aplikimi i pullave të kontrollit të barnave, për barnat që prodhohen në vend, do të kryhet në fabrikën prodhuesve vendase, para hedhjes në treg të tyre.

1.5 Aplikimi i pullave të kontrollit të barnave, për barnat që importohen në vend, do të kryhet jashtë Shqipërisë, nga mbajtësi i autorizimit për tregtim.

1.6 Përfundimisht, Këshilli i Ministrave do të përcaktojë barnat dhe vëllimet, për të cilat aplikimi i pullës së kontrollit të barnave do të kryhet nga importuesi i autorizuar, në Shqipëri, nën mbikëqyrjen e inspektorëve të QKKB-së.

1.7 Barnat e destinuar për eksport nuk pajisen me pullën e kontrollit të barnave.

2. Përkufizime

Termat e mëposhtëm kanë kuptim për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi, si vijon:

2.1 “Autoritet” është Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave.

2.2 “Ligji për barnat” është ligji nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në RSH”, të ndryshuar.

2.3 “Ligji për miratimin e kontratës së koncesionit” është ligji nr. 10 381, datë 24.2.2011 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoritet kontraktues dhe shoqërive “Sicpa Security Solutions S.A.” e “Sicpa Security Solutions Albania sh.p.k.”, për projektimin, financimin, dizejnimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”.

2.4 “Koncesionar” është “Sicpa Security Solutions S.A.” e “Sicpa Security Solutions Albania sh.p.k.” (dhe nënkontraktorët e miratuar sipas përcaktimeve të ligjit “Për miratimin e kontratës së koncesionit”).

2.5 “Personel i autorizuar” janë punonjësit e koncesionarit, të emëruar për të asistuar në instalimin dhe vënien në punë të sistemit të monitorimit, si dhe për ta përfaqësuar atë përpara Autoritetit.

2.6 “Pulla e kontrollit të barnave” është pulla e Republikës së Shqipërisë, e miratuar nga Autoriteti, e cila aplikohet detyrimisht mbi të gjitha barnat që prodhohen në vend me destinacion tregun shqiptar, si dhe barnat, që importohen nga jashtë, me destinacion tregun vendas, në përputhje me ligjin për barnat, ligjin për miratimin e kontratës së koncesionit dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre. Pulla e kontrollit të barnave në formatin e pullës së vetme përmban, detyrimisht, elementet, si: Ministria e Shëndetësisë, Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave, emrin dhe formë dozën e barit, çmimin e shitjes me pakicë të barit (përfshirë TVSH-në) një kod dyshifror për identifikimin e mbajtësit të autorizimit të tregtimit, të prodhuesit apo të importuesit të autorizuar, numrin serial të dukshëm të referencës, si dhe një barkod (Sicpadata Code) të lexueshëm nëpërmjet lexuesve *Sicpamobile Reader*.

2.7 “Pulla e dyfishtë e kontrollit të barnave” është pulla e Republikës së Shqipërisë, e miratuar nga Autoriteti, e cila aplikohet detyrimisht mbi të gjitha barnat që prodhohen në vend me destinacion tregun shqiptar, si dhe barnat, që importohen nga jashtë, me destinacion tregun vendas, në përputhje me ligjin për barnat, ligjin për miratimin e kontratës së koncesionit dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre. Pulla e dyfishtë e kontrollit të barnave përmban, detyrimisht, në një nga pjesët e pullës që mbetet në paketimin e barit, elementet, si: Ministria e Shëndetësisë, Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave, emrin dhe formë - dozën e barit, çmimin e shitjes me pakicë të barit (përfshirë TVSH-në), një kod dyshifror për identifikimin e mbajtësit të autorizimit të tregtimit, të prodhuesit apo të importuesit të autorizuar, numrin serial të dukshëm të referencës, si dhe një barkod (Sicpadata Code) të lexueshëm nëpërmjet lexuesve *Sicpamobile Reader*. Pjesa e pullës që



shkëputet dhe vendoset në recetën e mjekut, përmban detyrimisht, elementet, si: emrin dhe formëdozën e barit, çmimin e shitjes me pakicë të barit (përfshirë TVSH-në) një kod dyshifror për identifikimin e mbajtësit të autorizimit të tregtimit, të prodhuesit apo të importuesit të autorizuar dhe numrin serial të dukshëm të referencës.

2.8 “Qendra e Kodimit dhe Personalizimit” (QKP) është ambienti në të cilin koncesionari shpërndan pullat e kontrollit të barnave, në përputhje me vendimin e Autoritetit.

2.9 “Sistemi qendror i monitorimit të gjurmëve dhe shenjave” është sistemi kompjuterik i cili mban dhe administron bazën e të dhënave për pullat fiskale, pullat e akcizës dhe pullat e kontrollit të barnave.

2.10 “Prodhuesi vendas” është personi juridik, vendas ose i huaj, i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e fabrikimit të barnave, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe marrëveshjet tregtare ndërkombëtare e rajonale të ratifikuara, për prodhimin e barnave me destinacion tregun vendas apo eksportin e tyre.

2.11 “Kompania prodhuese e huaj” është fabrika prodhuese e huaj ose mbajtësi i autorizimit për tregtim, që prodhon dhe/ose regjistron barna në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të ligjit për barnat.

2.12 “Importues i autorizuar” është njësi tregtare farmaceutike shqiptare e licencuar, që importon, eksporton dhe/ose shpërndan barnat e furnizuara nga fabrikuesi i huaj ose mbajtësi i autorizimit për tregtim, sipas autorizimit përkatës.

2.13 “Ditë” janë ditë pune brenda orarit zyrtar të administratës të përcaktuar në legjislacionin shqiptar në fuqi.

3. Prodhimi dhe kodimi i pullave të kontrollit të barnave nga koncesionari

3.1 Pulla e kontrollit të barnave prodhohet, u shpërndahet subjekteve farmaceutike (prodhues vendas, kompani prodhuese të huaja/mbajtës të autorizimit për tregtim, importues të autorizuar) dhe monitorohet, në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë, nga koncesionari, në përputhje me tagrat e përcaktuara në ligjin për miratimin e kontratës së koncesionit, ligjit për barnat, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre.

3.2 Koncesionari prodhon dhe kodon pullat e kontrollit të barnave, në përputhje me sasinë, specifikimet teknike, si dhe të dhënat e miratuara nga autoriteti.

3.3 Dizenjoja dhe elementet e pullës së vetme të kontrollit të barnave, miratohen nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave për Koncesionarin.

3.4 Pulla e dyfishtë e kontrollit të barnave përbëhet nga një pullë bazë, e cila mbetet në paketimin e barit, dhe një pullë vetëngjithëse. Pulla vetëngjithëse shkëputet nga paketimi i barit nga farmacisti dhe vendoset mbi recetën e mjekut, kur kjo recetë paraqitet nga pacienti në momentin e tërheqjes së barit, rast pas rasti, me qëllim kontrollin dhe monitorimin e shitjes së barnave me recetën e mjekut dhe funksionimit të skemës së rimbursimit të barnave. Dizenjoja dhe elementet e pullës së dyfishtë të kontrollit të barnave, miratohen nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave, për koncesionarin. Këshilli i Ministrave përcakton kohën kur do të fillojë aplikimi i pullës dyfishe. Koncesionari, prodhuesit vendas dhe importuesit e autorizuar të barnave, do të njoftohen mbi datën e fillimit të aplikimit të paktën 6 muaj para.

3.5 Ndalohet importimi, prodhimi, mbajtja, shitja ose postimi për shitje i etiketave të stampimit (pullave të kontrollit të barnave) ose materialeve të tjera të koncesionarit, që sugjerojnë, printojnë, imitojnë ose falsifikojnë pullën e kontrollit të barnave.

3.6 Ndalohet kryerja e çdo ndërhyrjeje teknike që ka për qëllim kopjimin ose falsifikimin e elementeve të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave.

4. Porositja e pullave të kontrollit të barnave nga prodhuesit vendas

4.1 Prodhuesit vendas duhet të dorëzojnë pranë autoritetit të dhënat në përputhje me aneksin nr. 1 të këtij udhëzimi, përpara datës së fillimit të porositjes së pullave ose në çdo rast kur ka ndryshim të të dhënave të prodhuesit.

4.2 Prodhuesi vendas i dorëzon autoritetit, nëpërmjet sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, jo më vonë se në ditën e shtatë të punës ose me shkrim jo më vonë se në ditën e dytë të punës, të çdo muaji janar, prill, korrik dhe tetor, të çdo viti, një parashikim me të dhënat mbi numrin e pullave të kontrollit që synon të tërheqë në QKP. Parashikimi përfshin të dhëna të detajuara të sasive për çdo muaj, për periudhën 3-mujore në vazhdim (p.sh., një parashikim i dorëzuar më 7 janar duhet të japë të dhënat për secilin nga muajt shkurt, mars, prill). Gjithashtu, çdo parashikim do të përfshijë edhe parashikimin vjetor të vitit kalendarik aktual dhe duke filluar nga parashikimi i muajit korrik do të përfshijë edhe parashikimin vjetor të vitit pasardhës.

4.3 Prodhuesi vendas paraqet kërkesën për t'u pajisur me pulla, pranë Autoritetit, jo më vonë se 15 ditë pune, përpara datës në të cilën synon të tërheqë pullat e stampuara pranë Qendrës së Kodimit dhe Personalizimit.

4.4 Kërkesa për t'u pajisur me pulla (porosia) pranë Autoritetit, bëhet nëpërmjet:

a) sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, të mundësuar nga Autoriteti; ose

b) duke plotësuar formularin e miratuar nga Autoriteti për këtë qëllim dhe dorëzimit të këtij formulari tek Autoriteti në mënyrë elektrike ose me shkrim.

4.5 Prodhuesi vendas për secilin bar që prodhon, plotëson kërkesën për t'u pajisur me pulla, e cila detyrimisht duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:

- 1) Emri i barit;
- 2) Principi aktiv;
- 3) Formë-doza, paketimi i barit;
- 4) Emri i prodhuesit;
- 5) Numri i serisë;
- 6) Sasia e prodhuar për këtë seri, ekuivalente me sasinë e porositur të pullave të kontrollit (sasia minimale e porosisë është 5 pulla, me tejkalim të sasisë deri në 5 pulla);
- 7) Data e prodhimit;
- 8) Data e skadencës;
- 9) Çmimi i barit ose përdorim spitalor/donacion/promocion;
- 10) Numri dhe data e certifikatës së regjistrimit/riregjistrimit;
- 11) Numri dhe data e autorizimit të veçantë të Ministrisë së Shëndetësisë (nëse aplikohet);
- 12) Emri, adresa dhe detaje të prodhuesit vendas, i cili do të tërheqë pullat pranë Qendrës së Kodimit dhe Personalizimit.

5. Porositja e pullave të kontrollit të barnave nga importuesit e autorizuar

5.1 Importuesit e autorizuar duhet të dorëzojnë pranë Autoritetit të dhënat në përputhje me aneksin nr. 1 të këtij udhëzimi, përpara datës së fillimit të porositjes së pullave ose në çdo rast kur ka ndryshim të të dhënave të importuesit të autorizuar.

5.2 Importuesi i autorizuar i dorëzon Autoritetit, nëpërmjet sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, jo më vonë se në ditën e shtatë të punës, ose me shkrim jo më vonë se në ditën e dytë të punës, të çdo muaji janar, prill, korrik dhe tetor, të çdo viti, një parashikim me të dhënat mbi numrin e pullave të kontrollit që synon të aplikohen për barnat që parashikon të importojë nga jashtë me destinacion tregun vendas. Parashikimi përfshin të dhëna të detajuara të sasive për çdo muaj, për periudhën 3-mujore në vazhdim (p.sh., një parashikim i dorëzuar më 7 janar, duhet të japë të dhënat për secilin nga muajt shkurt, mars, prill). Gjithashtu, çdo parashikim do të përfshijë edhe parashikimin vjetor të vitit kalendarik aktual dhe duke filluar nga parashikimi i muajit korrik do të përfshijë edhe parashikimin vjetor të vitit pasardhës.

5.3 Importuesi i autorizuar paraqet kërkesën për t'u pajisur me pulla, pranë Autoritetit, jo më vonë se 15 ditë përpara datës në të cilën synon të importojë barna në vend.

5.4 Kërkesa për t'u pajisur me pulla (porosia) pranë Autoritetit, bëhet nëpërmjet:

a) sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, të mundësuar nga Autoriteti;



ose

b) duke plotësuar formularin e lëshuar nga Autoriteti për këtë qëllim dhe dorëzimit të këtij formulari tek Autoriteti në mënyrë elektronike ose me shkrim.

5.5 Kërkesa për t'u pajisur me pulla duhet të shoqërohet, të paktën, me dokumentacionin si më poshtë:

1) Licencën profesionale për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit me shumicë të barnave;

2) Kontratën e lidhur midis importuesit të autorizuar dhe kompanisë prodhuese të huaj mbajtësit të autorizimit për tregtim, ose deklaratën e mbajtësit të autorizimit për tregtim, që vërteton se importuesi vendas është i autorizuar për tregtimin e këtyre barnave në Shqipëri.

5.6 Importuesi i autorizuar, për secilin bar që synon të importojë, plotëson kërkesën për t'u pajisur me pulla, nën përgjegjësinë e tij, detyrimisht, të paktën për të dhënat e mëposhtme:

1) Emri i barit;

2) Principi aktiv;

3) Formë-doza, paketimi i barit;

4) Emri i prodhuesit/mbajtësit të autorizimit për tregtim;

5) Emri i importuesit;

6) Numri i serisë;

7) Sasia që importohet për këtë seri, ekuivalente me sasinë e porositur të pullave të kontrollit (sasia minimale e porosisë është 5 pulla, me tejkalim të sasisë deri në 5 pulla);

8) Data e prodhimit;

9) Data e skadencës;

10) Çmimi CIF i barit ose përdorim spitalor/donacion/promocion;

11) Numri dhe data e certifikatës së regjistrimit/riregjistrimit;

12) Numri dhe data e autorizimit të veçantë të Ministrisë të Shëndetësisë (nëse aplikohet);

13) Emri, adresa dhe detaje për prodhuesin e huaj ose mbajtësin e autorizimit për tregtim, ku do të dërgohen pullat për t'u aplikuar mbi paketimin e barit, para se të importohen në Shqipëri.

6. Miratimi nga Autoriteti i kërkesës për t'u pajisur me pulla

6.1 Autoriteti verifikon dhe aprovon kërkesën për t'u pajisur me pulla, brenda 2 ditëve nga data e marrjes së saj.

6.2 Autoriteti, brenda 1 dite nga data e verifikimit dhe aprovimit të kërkesës për t'u pajisur me pulla, urdhëron koncesionarin të prodhojë pullat, të stampojë të dhënat e dukshme dhe të hedhë të dhënat e padukshme mbi pulla.

6.3 Autoriteti e urdhëron koncesionarin, nëpërmjet:

a) Dërgimit të urdhrin në rrugë elektronike, në sistemin qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave; ose

b) Dërgimit të urdhrin me shkrim.

6.4 Autoriteti urdhëron koncesionarin të dorëzojë pullat e stampuara, sipas kërkesës së prodhuesit vendas të aprovuar nga Autoriteti, drejtpërdrejt personit të autorizuar nga prodhuesi vendas për tërheqjen e tyre në Qendrën e Kodimit dhe Personalizimit, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se në datën e përcaktuar nga Autoriteti në urdhrin e miratimit, brenda afateve maksimale të përcaktuara në ligjin për miratimin e kontratës së koncesionit.

6.5 Autoriteti urdhëron koncesionarin të dërgojë pullat e stampuara drejtpërdrejt te mbajtësi i autorizimit për tregtim/fabrikuesi i huaj jashtë vendit, ose t'ia dorëzojë importuesit të autorizuar, në adresën e plotë të specifikuar nga importuesi i autorizuar, sipas kërkesës së importuesit të autorizuar të miratuar nga Autoriteti, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se në datën e përcaktuar nga Autoriteti në urdhrin e miratimit, brenda afateve maksimale të përcaktuara në ligjin "Për miratimin e kontratës së koncesionit". Importuesi i autorizuar është përgjegjës për deklarin e saktë të të dhënave për fabrikuesin e huaj/mbajtësin e autorizimit për tregtim.

6.6 Në raste të veçanta, aplikimi i pullës së kontrollit të barnave do të kryhet nga importuesi i autorizuar në Shqipëri, nën mbikëqyrjen e inspektorëve të QKKB-së, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili përcakton barnat dhe vëllimet për të cilat do të ndiqet kjo procedurë.

6.7 Koncesionari nuk duhet të ndryshojë të dhënat e dërguara në urdhrin e Autoritetit, përveçse kur kjo gjë i kërkohet nga vetë Autoriteti, nëpërmjet një prej mënyrave të përmendura në pikën 6.3.

6.8 Koncesionari zbaton vetëm urdhrin e Autoritetit për sa u përket: prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave.

6.9 Koncesionari nuk merr parasysh dhe nuk zbaton asnjë kërkesë për t'u pajisur me pulla të paraqitura nga prodhuesit vendas, fabrikuesit e huaj/importuesit e autorizuar ose subjekte të tjera.

7. Çmimi i pullës së kontrollit të barnave

Në përputhje me pikën 17.1 të ligjit "Për miratimin e kontratës së koncesionit", çmimi i pullës së vetme të kontrollit të barnave është 14,43 euro për 1.000 (një mijë) copë pulla. Në këtë çmim, nuk është përfshirë TVSH-ja dhe çdo taksë tjetër e zbatueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

8. Faturimi i pullës së kontrollit të barnave

8.1 Koncesionari, në lidhje me secilën kërkesë për t'u pajisur me pulla, të miratuar nga Autoriteti, përgatit dhe shpërndan te prodhuesi vendas apo importuesi i autorizuar që ka bërë kërkesën, faturën përkatëse për këtë kërkesë, ku specifikohet, në veçanti, si vijon:

a) shuma në euro (dhe shuma e konvertuar në lekë, sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë, në ditën e lëshimit të faturës për qëllim informimi), që i detyrohet prodhuesi vendas apo importuesi i autorizuar koncesionarit, në lidhje me sasinë dhe llojin e pullave të porositura, të përlllogaritura në përputhje me sasinë e kërkuar dhe çmimin e pullës sipas pikës 7 të këtij udhëzimi;

b) shumën e TVSH-së së llogaritur;

c) numrin e llogarisë në Shqipëri ku do të kryhet pagesa;

d) fatura do të përfshijë, gjithashtu, kostot e dërgesës për pullat, të cilat do të dërgohen jashtë vendit nga koncesionari, si dhe adresën e marrësit të pullave.

9. Pagesa e pullave të kontrollit të barnave

9.1 Sasia e porositur e pullave të kontrollit, do t'i dorëzohet prodhuesit vendas ose do të dërgohet në adresën e specifikuar nga importuesi i autorizuar jashtë vendit, vetëm pas kryerjes së pagesës së plotë të faturuar për secilën porosi. Kryerja e pagesës do të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së mandatit të pagesës së shumës së faturuar, në përputhje me pikën 8.

9.2 Pagesa e pullave të kontrollit të barnave, si dhe shpenzimet përkatëse në lidhje me shpërndarjen e tyre, duhet të parapaguhet në euro nga prodhuesi vendas apo importuesi i autorizuar. Në këtë vlerë do të përfshihet TVSH-ja dhe çdo lloj tjetër takse apo tatimi, të aplikueshme në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Pagesa kryhet brenda 8 ditëve pune nga marrja e faturës.

9.3 Në rast të moskryerjes së pagesës paraprake, për të gjithë shumën e faturuar në lidhje me porosinë, koncesionari do të pezullojë dorëzimin apo dërgesën e pullave të kontrollit, te prodhuesi vendas apo importuesi i autorizuar, deri sa këto subjekte t'i kenë paguar koncesionarit të gjithë shumën e mbetur të faturuar në lidhje me porosinë.

10. Shpërndarja e pullave të kontrollit të barnave për barnat e prodhuara në vend

10.1 Pullat e kontrollit të barnave shpërndahen nga koncesionari në rulona me pulla me vetëngjitje në Qendrën e Kodimit dhe Personalizimit. Koncesionari do të përcaktojë njësitë e plota të paketimit të përshtatshëm për çdo porosi.

10.2 Koncesionari do t'i konfirmojë prodhuesit vendas një datë disponueshmërie për tërheqjen e pullave pranë Qendrës së Kodimit dhe Personalizimit, e cila do të jetë "sa më shpejt të jetë e mundur", por jo më vonë se 12 ditë pune pas datës së miratimit nga Autoriteti.



10.3 Në rast se sasia e kërkuar e pullave, e porositur nga prodhuesi vendas, shmanget me 25% ose më shumë, por më pak se 100% nga sasia e specifikuar në parashikimet e bëra nga ky prodhues sipas paragrafit 4.2 të këtij udhëzimi, datë disponueshmërie do të jetë “sa më shpejt të jetë e mundur”, por jo më vonë se 22 ditë pune pas datës së miratimit nga Autoriteti. Në rast se sasia e porositur shmanget me 100% ose më shumë nga sasia e specifikuar në parashikim, koncesionari duhet të përpiqet ta plotësojë porosinë sa më shpejt, por nuk angazhohet për ta plotësuar brenda 22 ditëve.

10.4 Koncesionari i mban në Qendrën e Kodimit dhe Personalizimit këto pulla, për jo më shumë se 60 ditë pune nga data e disponueshmërisë.

10.5 Çdo prodhues vendas duhet t'i sigurojë koncesionarit, me shkrim ose me anën e Sistemit Qendror të Monitorimit të Gjurmëve dhe Shenjave, emrin dhe numrin e telefonit të personit të autorizuar, i cili do të verifikojë dhe pranojë cilësinë dhe sasinë e pullave të kontrollit, para tërheqjes së tyre në Qendrën e Kodimit dhe Personalizimit.

10.6 Në çdo rast, Autoriteti ka të drejtë të verifikojë cilësinë dhe sasinë e pullave para shpërndarjes së tyre te prodhuesi vendas.

10.7 Në rast të mospranimit të pullave të kontrollit të barnave nga prodhuesi vendas, për shkak të identifikimit të defekteve në pullë ose rulon, prodhuesi vendas informon me shkrim koncesionarin se janë identifikuar pulla defekteze, jo më vonë se 10 ditë pune nga data e marrjes së pullave. Prodhuesi vendas do të japë të dhëna dhe detaje për pullat, rulonin dhe sasinë me defekt, foto ose shembuj të pjesëve me defekt. Koncesionari duhet t'i lëshojë menjëherë prodhuesit vendas një autorizim të kthimit për pjesët me defekt në njësi të plota paketimi. Koncesionari njofton menjëherë Autoritetin se një dërgesë me pulla me defekt është kthyer te magazina e tij. Nëse ka problem me cilësinë e pullave ose sasinë e pullave në rulon, koncesionari duhet menjëherë të zëvendësojë dhe dorëzojë pa pagesë te prodhuesi vendas, sasinë defekteze ose të munguar.

11. Shpërndarja e pullave të kontrollit të barnave për barnat që importohen

11.1 Pullat e kontrollit të barnave shpërndahen nga koncesionari në rulona me pulla me vetëngjitje në Qendrën e Kodimit dhe Personalizimit. Koncesionari do të përcaktojë njësitë e plota të paketimit të përshtatshëm për çdo porosi.

11.2 Koncesionari do t'i konfirmojë importuesit të autorizuar një datë disponueshmërie për të kontrolluar sasinë e pullave të porositura, para dërgimit në adresën e specifikuar nga importuesi i autorizuar jashtë vendit, e cila do të jetë “sa më shpejt të jetë e mundur”, por jo më vonë se 12 ditë pune pas datës së miratimit nga Autoriteti.

11.3 Në rast se sasia e kërkuar e pullave e porositur nga importuesi i autorizuar, shmanget me 25% ose më shumë, por më pak se 100% nga sasia e specifikuar në parashikimet e bëra nga ky importues sipas paragrafit 5.2 të këtij udhëzimi, datë disponueshmërie do të jetë “sa më shpejt të jetë e mundur”, por jo më vonë se 22 ditë pune pas datës së miratimit nga Autoriteti. Në rast se sasia e porositur shmanget me 100% ose më shumë nga sasia e specifikuar në parashikim, koncesionari duhet të përpiqet ta plotësojë porosinë sa më shpejt, por nuk angazhohet për ta plotësuar brenda 22 ditëve.

11.4 Koncesionari, jo më vonë se data e disponueshmërisë së porosisë së pullave, do t'ia dorëzojë pullat një agjenti dërgesash me reputacion, për llogari të importuesit të autorizuar, për t'i dërguar te prodhuesi i huaj/mbajtësi i autorizimit për tregtim, jashtë vendit. Koncesionari do t'i shesë pullat e kontrollit të barnave, me kushtet e dërgesës në destinacion DAP (Delivery At Place sipas INCOTERMS 2010), duke përfshirë TVSH-në, si dhe tarifën për transportin, dorëzimin, sigurimin. Importuesi i autorizuar ka të drejtë të jetë i pranishëm kur pullat paketohen dhe ngarkohen për t'u dërguar tek agjenti i dërgesës. Personi i ngarkuar nga importuesi i autorizuar, verifikon dhe pranon cilësinë (për defekte/dëmtime të dukshme) dhe sasinë e pullave përpara dorëzimit të tyre tek agjenti i dërgesave. Koncesionari nuk mbart detyrimin e transportit dhe gjurmimit të ngarkesës. Koncesionari nuk tarifon prodhuesin e huaj/mbajtësin e autorizimit për

tregtim, për dorëzimin e pullave.

11.5 Çdo importues i autorizuar duhet t'i sigurojë koncesionarit, me shkrim ose me anën e sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, emrin dhe numrin e telefonit të personit të autorizuar, i cili do të verifikojë dhe do të pranojë cilësinë dhe sasinë e pullave të kontrollit, përpara dorëzimit të këtyre pullave tek agjenti i dërgesave.

11.6 Në raste të veçanta, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili përcakton barnat dhe vëllimet, pullat e kontrollit do t'i dorëzohen importuesit të autorizuar në Qendrën e Kodimit dhe Personalizimit, për aplikimin e tyre në ambientet e importuesit të autorizuar në vend, nën mbikëqyrjen e inspektorëve të Autoritetit.

11.7 Në çdo rast, Autoriteti ka të drejtë të verifikojë cilësinë dhe sasinë e pullave, para dorëzimit të tyre tek agjenti i speditonit, për shpërndarje te prodhuesi i huaj/mbajtësi i autorizimit për tregtim jashtë vendit.

11.8 Në rast të mospranimit të pullave të kontrollit të barnave nga mbajtësi i autorizimit për tregtim/kompania prodhuese e huaj, për shkak se janë identifikuar defekte në pullë ose rulon, mbajtësi i autorizimit për tregtim/kompania prodhuese e huaj informon me shkrim koncesionarin se janë identifikuar pulla defektoze. Mbajtësi i autorizimit për tregtim/kompania prodhuese e huaj do të japë të dhëna dhe detaje për pullat, rulonin dhe sasinë me defekt, foto ose shembuj të pjesëve me defekt. Koncesionari duhet t'i lëshojë menjëherë mbajtësit të autorizimit për tregtim/kompanisë prodhuese të huaj një autorizim të kthimit për pjesët me defekt në njësi të plota paketimi. Kthimi bëhet nëpërmjet të njëjtit agjent të dërgesës, i cili duhet t'ia kthejë pullat me defekt koncesionarit. Tarifat e transportit do të paguhën nga koncesionari. Koncesionari njofton menjëherë Autoritetin se një dërgesë me defekt është kthyer te magazina e tij. Nëse ka problem me cilësinë e pullave ose sasinë e pullave në rulon, koncesionari duhet menjëherë të zëvendësojë dhe të dorëzojë pa pagesë te mbajtësi i autorizimit për tregtim/kompania prodhuese e huaj, sasinë defektoze ose të munguar.

11.9 Në rast të mospranimit të pullave të kontrollit të barnave nga mbajtësi i autorizimit për tregtim/kompania prodhuese e huaj, për çdo arsye tjetër, përveç atyre të përcaktuara në pikën 11.8 të këtij udhëzimi, agjenti i dërgesës duhet t'ia kthejë të gjithë sasinë koncesionarit. Tarifat e transportit të kthimit të pullave i kalojnë importuesit të autorizuar. Koncesionari njofton menjëherë Autoritetin se një dërgesë e papranuar është kthyer te magazina e tij. Koncesionari duhet të presë për udhëzime të mëtejshme nga Autoriteti në lidhje me këto pulla.

12. Aplikimi i pullave të kontrollit të barnave

12.1 Pulla e kontrollit të barnave duhet të vendoset në paketimin e barit, në përputhje me rregulloren e paketimit të barnave dhe direktivat e dhëna nga Autoriteti. Pulla e kontrollit nuk duhet të mbulohet me çfarëdoq material, i cili pengon leximin dhe autentifikimin e tyre.

12.2 Për barnat e prodhuara në vend, pulla e kontrollit aplikohet nga prodhuesit vendas, duke përdorur aplikuesit automatikë ose manualisht, nën kontrollin e inspektorëve të Autoritetit.

12.3 Për barnat që importohen në vend, pulla e kontrollit të barnave aplikohet nga prodhuesi i huaj/mbajtësi i autorizimit për tregtim jashtë vendit, duke përdorur aplikuesit automatikë ose manualisht.

12.4 Në raste të veçanta, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili përcakton barnat dhe vëllimet, pullat e kontrollit do të aplikohen në ambientet e importuesit të autorizuar në vend, nën mbikëqyrjen e inspektorëve të Autoritetit.

12.5 Prodhuesit vendas dhe importuesit e autorizuar/mbajtësit e autorizimit për tregtim/kompanitë prodhuese të huaja, duhet të sigurohen se pulla e kontrollit të barnave, e aplikuar në paketimin e barit, i korrespondon emrit të barit, formë-dozës, paketimit, çmimit të shitjes me pakicë, numrit të referencës dhe identifikimit. Ministria e Shëndetësisë, Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave, Ministria e Financave dhe/ose koncesionari, nuk mbajnë përgjegjësi për aplikim të gabuar të pullave të barnave dhe çdo pasojë që rrjedh prej kësaj.

13. Aktivizimi i pullës së kontrollit të barnave për barnat e prodhuara në vend



13.1 Autoriteti verifikon nëse të dhënat e barit të prodhuar dhe të dhënat e pullës përkatëse, të aplikuar mbi paketim në ambientet e prodhuesit vendas, janë të sakta dhe përputhen.

13.2 Pulla e kontrollit aktivizohet nga Autoriteti në sistemin qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, menjëherë pasi Autoriteti lejon hedhjen në treg nëpërmjet dhënies së autorizimit për përdorim të barnave.

13.3 Në rast se ka mospërputhje midis të dhënave të barit dhe të dhënave të pullës me të cilën është pajisur ky bar, Autoriteti bën verifikimet dhe merr masat përkatëse.

14. Aktivizimi i pullës së kontrollit të barnave për barnat që importohen

14.1 Autoriteti verifikon nëse të dhënat e barit të importuar dhe të dhënat e pullës përkatëse të aplikuar mbi paketim nga mbajtësi i autorizimit për tregtim/kompania prodhuese e huaj, janë të sakta dhe përputhen. Ky verifikim kryhet në pikat doganore të hyrjes ose depon e importuesit të autorizuar.

14.2 Pulla e kontrollit aktivizohet nga Autoriteti në sistemin qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, menjëherë pasi Autoriteti lejon hedhjen në treg nëpërmjet dhënies së autorizimit për hedhjen në treg të barnave.

14.3 Në rast se ka mospërputhje midis të dhënave të barit dhe të dhënave të pullës me të cilën është pajisur ky bar, Autoriteti bën verifikimet dhe merr masat përkatëse.

15. Monitorimi i pullave të kontrollit të barnave

15.1 Të gjitha barnat që qarkullojnë në vend, kontrollohen nëpërmjet procesit të monitorimit të pullës së kontrollit, me të cilën pajisen këto barna. Inspektimet kryhen në pikat doganore të hyrjes, depon e importuesit të autorizuar, farmaci, agjenci farmaceutike, si dhe farmacitë e spitaleve/klinikave shtetërore e private etj., nga inspektorët e Autoritetit.

15.2 Skanerët Sicpamobile duhet të sigurojnë *on-line* të gjitha të dhënat e hedhura në bazën e të dhënave të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, duke garantuar informacionin për çdo bar të pajisur me pullë, pas skanimit të kodit.

15.3 Pullat e kontrollit të barnave me defekt, pullat e dëmtuara gjatë procesit të aplikimit dhe pullat e tepërta të paaplikuara në paketim, dërgohen për t'u shkatërruar pranë Autoritetit, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për administrimin e vlerave materiale dhe monetare.

16. Zbatimi i këtij udhëzimi

16.1 Për të gjitha subjektet farmaceutike zbatimi do të fillojë 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, nuk do të lejohen të importohen barna, si dhe nuk do të lejohen të hidhen në treg barna të prodhuara në vend, pa pullën e vetme të kontrollit të barnave të prodhuar nga koncesionari.

16.2 Pas periudhës prej 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, inspektimet nga Autoriteti në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi, do të kryhen në të gjithë territorin e vendit. Për shkeljen e dispozitave të këtij udhëzimi, do të zbatohen sanksionet e përcaktuara në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në RSH", i ndryshuar.

16.3 Koncesionari duhet të fillojë të pranojë porosi për pullën e vetme të kontrollit të barnave, të ketë të disponueshme pullat e kontrollit në QKP, të ketë pajisur dhe trajnuar për përdorim inspektorët e QKKB-së me skanerët Sicpamobile Reader dhe bërë të mundur inspektimin nëpërmjet tyre në të gjithë territorin e vendit, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

17. Dispozita përfundimtare

17.1 Dispozitat e parashikuara në akte të tjera nënligjore, të cilat bien në kundërshtim me këtë udhëzim, nuk do të zbatohen.

17.2 Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË

Vangjel Tavo

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

ANEKSI I

Të dhënat kryesore të prodhuesit vendas dhe importuesit të autorizuar të barnave

1. Në tabelën më poshtë jepen të dhënat që duhet të dorëzojë prodhuesi vendas pranë Autoritetit, përpara datës së fillimit të porositjes së pullave ose në çdo rast kur ka ndryshim të të dhënave të prodhuesit, sipas pikës 4.1 të këtij udhëzimi.

Nr.	Të dhënat bazë për prodhuesin vendas	Vërejtje për plotësimin e të dhënave
1.	Emri i subjektit	E detyrueshme
2.	Numri dhe data e licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)	E detyrueshme
3.	Numri i personit të tatueshëm (NIPT)	E detyrueshme
4.	Adresa e subjektit	E detyrueshme
5.	Kodi postar	E detyrueshme
6.	Qyteti	E detyrueshme
7.	Adresa e faturës	Përdoret nëse adresa e faturës është ndryshe nga adresa kryesore
8.	Emri i personit/personave të autorizuar që duhet të verifikojnë, pranojnë dhe tërheqin porosinë e pullave në qendrën e kodimit	E detyrueshme
9.	Numër telefoni	E detyrueshme
10.	Adresë e-mail-i	E detyrueshme. Përdoret për njoftimet me postë elektronike
11.	Gjuha që do të përdoret për komunikimin	E detyrueshme. Shqip dhe/ose anglisht.

2. Në tabelën më poshtë jepen të dhënat që duhet të dorëzojë importuesi i autorizuar pranë autoritetit, përpara datës së fillimit të porositjes së pullave ose në çdo rast kur ka ndryshim të të dhënave të importuesit të autorizuar ose mbajtësit të autorizimit për tregtim/ prodhuesit të huaj, sipas pikës 4.2 të këtij udhëzimi.

Nr.	Të dhënat bazë për importuesin e autorizuar	Vërejtje për plotësimin e të dhënave
1.	Emri i subjektit	E detyrueshme
2.	Numri dhe data e licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)	E detyrueshme
3.	Numri i personit të tatueshëm (NIPT)	E detyrueshme



4.	Adresa e subjektit		E detyrueshme
5.	Kodi postar		E detyrueshme
6.	Qyteti		E detyrueshme
7.	Adresa e faturës		Përdoret nëse adresa e faturës është ndryshe nga adresa kryesore
8.	Emri i personit/personave të autorizuar që duhet të kontrollojnë porosinë e pullave në qendrën e kodimit		E detyrueshme
9.	Numër telefoni		E detyrueshme
10.	Adresë e-mail-i		E detyrueshme. Përdoret për njoftimet me postë elektronike
11.	Emri i mbajtësit të autorizimit për tregtim/prodhuesit të huaj, ku do të dërgohen pullat		E detyrueshme. Të listohen të gjithë mbajtësit e autorizimit për tregtim/prodhuesit të huaj me të cilët ka marrëveshje
12.	Adresa e mbajtësit të autorizimit për tregtim/ prodhuesit të huaj		E detyrueshme. Të listohen të gjitha adresat e mbajtësve të autorizimit për tregtim/prodhuesve të huaj me të cilët ka marrëveshje.
13.	Qyteti		E detyrueshme
14.	Rajoni		E detyrueshme
15.	Shteti		E detyrueshme
16.	Kodi postar		E detyrueshme
17.	Emri i personit/personave të autorizuar nga mbajtësi i autorizimit për tregtim/ prodhuesi i huaj, që duhet të verifikojnë, pranojnë dhe tërheqin porosinë e pullave		E detyrueshme
18.	Numër telefoni		E detyrueshme
19.	Adresë e-mail-i		E detyrueshme. Përdoret për njoftimet me postë elektronike
20.	Gjuha që do të përdoret për komunikimin		E detyrueshme. Shqip dhe/ose anglisht.

VENDIM
Nr.1, datë 17.1.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, paragrafi 4, shkronja “b”, nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 4 paragrafi 46 dhe të nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja “Për licencimin e subjekteve jobanka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 25.2.2009, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
**PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE
JOBANKA**

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kërkesave, afateve, dokumentacionit dhe procedurave për:

a) licencimin e subjekteve financiare jobanka, institucioneve financiare të mikrokredisë dhe të institucioneve të parasë elektronike për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë;

b) dhënien e miratimeve paraprake gjatë ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve financiare jobanka, të institucioneve të mikrokredisë dhe të institucioneve të parasë elektronike;

c) detyrimet për njoftime në Bankën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve financiare jobanka, institucioneve të mikrokredisë dhe të institucioneve të parasë elektronike;

d) miratimin e agjentit të subjekteve financiare jobanka.



Neni 2

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 1, paragrafi 4, shkronja “b” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) nenit 4, paragrafi 46 dhe të nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji për bankat.

Neni 3

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë personat që kërkojnë të licencohen për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë, subjektet financiare jobanka dhe agjentët e tyre, institucionet financiare të mikrokredisë dhe institucionet e parasë elektronike.

Neni 4

Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit për bankat kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “Mikrokredi” është kredia e lëvruar në shuma (vlera) jo më të mëdha se 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë ose kundërvlehtë e saj në valutë;

b) “Institucion financiar i mikrokredisë” është subjekti financiar jobankë që plotëson njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

i) ka si objekt të aktivitetit të tij vetëm kredidhënien dhe shërbimet këshilluese për veprimtarinë e kredidhënies;

ii) vlera mesatare e kredisë për një kredimarrës është jo më e madhe se vlera e mikrokredisë;

iii) të paktën 50 për qind e portofolit të kredisë përbëhet nga mikrokredi.

c) “Agjent” është personi juridik, i cili merr përsipër të drejtat dhe detyrimet për ushtrimin e veprimtarisë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave dhe/ose të shpërndarjes dhe ripagimit të fondeve, në rastin e institucioneve të parasë elektronike, të përcaktuara në kontratën përkatëse të agjencisë me subjektin financiar jobankë, sipas parashikimeve të bëra në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kërkesave të kësaj rregulloreje.

d) “Administrator” është individ sipas kuptimit të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

e) “Bashkimi me përthithje” është bashkimi i dy ose më shumë subjekteve financiare jobanka, nëpërmjet transferimit të totalit të aktiveve dhe të pasiveve të subjekteve të përthithura, tek një subjekt tjetër ekzistues, i quajtur subjekti përthithës. Kjo formë riorganizimi sjell prishjen e subjekteve të përthithura, në këmbim të zotërimit të aksioneve/kuotave nga aksionerët/ortakët e subjekteve të përthithura, në subjektin përthithës.

f) “Bashkimi me krijim” është bashkimi i dy ose më shumë subjekteve financiare jobanka ekzistuese, për të themeluar një subjekt të ri, ku subjektet ekzistuese në fjalë e humbasin personalitetin e tyre juridik dhe krijohet një subjekt i ri. Subjekti i themeluar rishtazi do të zotërojë të gjitha aktivet dhe pasivet e subjekteve që po shkrihen, në këmbim të zotërimit të aksioneve/kuotave nga aksionerët/ortakët e subjektit/eve ekzistuese, në subjektin e ri.

g) “Ndarje me krijim” është ndarja e realizuar nëpërmjet transferimit, të të gjitha aktiveve dhe pasiveve, në dy ose më shumë subjekte financiare jobanka të themeluara rishtazi (pritëse), ku subjekti i ndarë vlerësohet i prishur pa likuidim.

h) “Ndarje me përthithje” është ndarja e realizuar nëpërmjet transferimit, të të gjitha aktiveve apo pasiveve, në dy ose disa subjekte financiare jobanka ekzistuese (pritëse), ku subjekti i ndarë vlerësohet i prishur pa likuidim.

KREU II LICENCIMI

Neni 5

Autoriteti licencues dhe veprimtaritë financiare

1. Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për:
 - a) licencimin e subjekteve financiare jobanka, për të ushtruar, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, një ose disa nga veprimtaritë financiare të mëposhtme:
 - i) të gjitha format e kredidhënies;
 - ii) faktoringun;
 - iii) qiranë financiare;
 - iv) të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
 - v) ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve;
 - vi) këmbimin valutë; dhe
 - vii) shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara nga pika “i” deri te “vi”, të kësaj shkronje;
 - b) licencimin e institucionit financiar të mikrokredisë, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;
 - c) licencimin e institucionit të parasë elektronike, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;
 - d) miratimin e agjentëve të subjekteve financiare jobanka.
2. E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë/ve financiare lind vetëm pasi subjekti pajiset me licencë ose merr miratimin përkatës nga Banka e Shqipërisë.
3. Subjektet financiare jobanka nuk mund të lidhin marrëveshje me të tretët (outsourcing), për të transferuar ushtrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm dhe/ose për ushtrimin e veprimtarive financiare të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 6

Kërkesa për kapitalin

1. Shuma përkatëse e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për t’u licencuar si subjekt financiar jobankë, është si më poshtë:
 - a) për të gjitha format e kredidhënies.....100,000,000 (njëqind milionë) lekë;
 - b) për faktoringun.....20,000,000 (njëzet milionë) lekë;
 - c) për qiranë financiare.....20,000,000 (njëzet milionë) lekë;
 - d) për shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave. 20,000,000 (njëzet milionë) lekë;
 - e) për ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve20,000,000 (njëzet milionë) lekë;
 - f) për këmbimin valutë.....1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;
 - g) për shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara nga shkronja “a” deri te shkronja “f”, të kësaj pike.....10,000,000 (dhjetë milionë) lekë.



2. Përjashtimisht nga përcaktimi i shkronjës “a” të paragrafit 1 të këtij neni, kapitali fillestar minimal i kërkuar për institucionin financiar të mikrokredisë është 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë.
3. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për të ushtruar veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave si agjent i një subjekti jobankë, është 1 (një) milion lekë.
4. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për institucionet e parasë elektronike është 20 (njëzet) milionë lekë.
5. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për subjektet financiare jobanka, që kërkojnë të kryejnë 2 (dy) ose më shumë veprimtari financiare nga ato të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, duhet të jetë i barabartë me shumën që i përket nivelit më të lartë të kapitalit të kërkuar në pikën 1 të këtij neni, ndër veprimtaritë për të cilat subjekti financiar jobankë kërkon të licencohet.
6. Çdo pagesë e kapitalit fillestar minimal dhe çdo shtesë e mëvonshme e tij shoqërohen me paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të informacionit lidhur me burimin e krijimit të këtij kapitali, sipas dokumentacionit të përcaktuar në shkronjën “g” të paragrafit 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.
7. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin/et e krijimit të kontributeve/fondeve që do të shërbejnë si kapital fillestar minimal ose si shtesë e mëvonshme e tij.
8. Pagesat dhe/ose shpenzimet për blerjen ose për marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal.

Neni 7

Karakteristikat e licencës

1. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patjetërsueshme.
2. Licenca përfshin emrin tregtar të subjektit, aktivitetet për të cilat është licencuar, numrin dhe datën e lëshimit të saj.
3. Licenca e institucionit financiar të mikrokredisë përfshin përveç emrit tregtar të subjektit dhe emërtimin “institucion financiar mikrokredie”.
4. Licenca e institucionit financiar të parasë elektronike përfshin përveç emrit tregtar të subjektit dhe emërtimin “institucion i parasë elektronike”

Neni 8

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për subjektin financiar jobankë, institucionin financiar të mikrokredisë dhe institucionin e parasë elektronike

1. Kërkesa për licencim si subjekt financiar jobankë, institucion financiar i mikrokredisë ose institucion i parasë elektronike bëhet me shkrim nga themeluesit ose administratori i subjektit, ose nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre.
2. Kërkesa shoqërohet nga formularët e plotësuar, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacioni i mëposhtëm:
 - a) statuti i shoqërisë;
 - b) akti i themelimit në rastin e një shoqërie të sapokrijuar;
 - c) lista e themeluesve dhe pjesëmarrja e tyre në kapitalin e shoqërisë;
 - d) ekstrakti i regjistrimit tregtar për regjistrimin e subjektit si person juridik, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria/të për të cilën/at subjekti kërkon të licencohet;
 - e) përshkrim i detajuar i aktivitetit të subjektit dhe paraqitja e pasqyrave financiare të audituara për tre vitet e fundit ose për periudhën e ekzistencës së shoqërisë, në rast se është një shoqëri që ka kryer më parë aktivitet;
 - f) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial për themeluesit, administratorin dhe/ose përfaqësuesin ligjor:

- i) se personi nuk është në ndjekje penale;
- ii) se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
- iii) se personi nuk është i dënuar penalisht; dhe
- iv) nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes në Bankën e Shqipërisë.

g) dokumentacioni për kapitalin dhe burimin e tij:

i) deklaratë noteriale të themeluesve se burimi i kapitalit fillestar të paguar të subjektit financiar jobankë, institucionit financiar të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta,

ii) deklaratë noteriale të themeluesve mbi burimin e krijimit të kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- për personat juridikë:

evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, bilanci kontabël vjetor, dhurata ose burime të tjera të destinuara për blerjen e aksioneve të subjektit financiar jobankë, institucionit financiar të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike) dhe certifikata e autoriteteve kompetente që siguron të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe rregullshmërinë e pagesës së tatimeve dhe taksave.

- për individët ose personat fizikë tregtarë:

evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka ose të tjera evidenca të burimit të fondeve) dhe certifikata e autoriteteve përkatëse fiskale shtetërore lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore; dhe

iii) vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë, që subjekti ka bllokuar, në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 6, paragrafët 1, 2, 3 ose 4 sipas rastit. Kjo shumë, zhbllokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës së Shqipërisë, në përfundim të procedurës së licencimit.

h) dokumentacioni për themeluesit, në rastin kur themeluesit janë persona juridikë:

i) statuti dhe ekstrakti i regjistrimit tregtar (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);

ii) vendimi i organit vendimmarrës të shoqërisë për pjesëmarrjen në kapitalin e subjektit financiar jobankë, institucionit financiar të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike;

iii) vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj); dhe

iv) në rastin e pjesëmarrjes influencuese, dokumentacioni plotësohet me të dhënat për veprimtarinë tregtare dhe pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e fundit, të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar.

i) dokumentacioni për themeluesit, në rastin kur themeluesit janë persona fizikë tregtarë ose individë:

- për personat fizikë tregtarë:

ekstraktin e regjistrimit në regjistrin tregtar dhe vërtetim nga organet e tatim-taksave për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale.

- për individët:

- dokumentin e identifikimit (emër, mbiemër, kombësia, shtetësia), adresa e saktë e vendbanimit dhe një CV e nënshkruar (sipas formularit nr. 4 të kësaj rregulloreje); dhe



- listën e bizneseve në të cilat themeluesi i subjektit financiar jobankë, institucionit financiar të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike ka pjesëmarrje influencuese, ekstraktin e regjistrit tregtar për secilin rast, si dhe të dhëna mbi ndonjë rast paaftësie paguese dhe/ose falimentimi;

j) dokumentacioni për administratorin:

i) vendimin e organeve vendimmarrëse të shoqërisë për emërimin e tij;

ii) dokumentin e identifikimit;

iii) CV-ja e nënshkruar (sipas formularit nr. 4 të kësaj rregulloreje);

iv) diplomën universitare dhe dokumente që vërtetojnë kualifikimet e tjera të administratorit;

v) të paktën një referencë nga punëdhënës të mëparshëm;

vi) deklaratë personale për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale; dhe

vii) deklaratë personale, që nuk ka qenë përgjegjës për falimentimin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik.

k) Planbiznesi i propozuar (sipas formularit nr. 9 të kësaj rregulloreje) me përmbajtje si më poshtë:

i) struktura e organizimit të shoqërisë dhe niveli i përgjegjësisë/ve;

ii) veprimtaritë financiare që parashikon të kryejë, vlerësimi i tregut, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;

iii) skema e realizimit të veprimtarisë së institucionit të parasë elektronike dhe përshkrim i masave për ruajtjen/sigurimin e fondeve të klientelës;

iv) identifikimi i rreziqeve, ndaj të cilave institucioni i parasë elektronike është i ekspozuar, duke përfshirë dhe agjentët/degët;

v) parashikimi i gjendjes financiare të subjektit për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së tij pas licencimit, pasqyrat financiare;

vi) burimet e financimit dhe struktura e aktiveve për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë pas licencimit;

vii) parimet, në bazë të të cilave është përgatitur plani i biznesit;

viii) një informacion, sipas formularit 6 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, lidhur me mjediset ku subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë parashikon të kryejë veprimtarinë/të; dhe

ix) një parashikim në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës (tregues të kujdesit, raporte etj.) për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë.

l) aktet e brendshme rregullative (rregulloret dhe/ose udhëzimet e brendshme), të miratuara nga organet vendimmarrëse për:

- veprimtarinë operationale të subjektit financiar jobankë, institucionit të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike;

- sistemin e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedura efektive administrative dhe kontabile;

- transparencën me klientin (mbrojtjen e konsumatorit);

- administrimin e rreziqeve;

- parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, duke përfshirë një program masash në përputhje me legjislacionin në fuqi, për parandalimin e pastrimit të parave;

- të siguruar vazhdimësinë dhe sigurinë në emetimin e parasë elektronike (për institucionet e parasë elektronike);

- organizimin, funksionimin dhe administrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë mënyrën e mbrojtjes/sigurisë së informacionit dhe të dhënave të klientëve.

3. Dokumentacioni sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse

në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni të jetë dhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

4. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 9

Kërkesa për administratorët

1. Administratorët e subjektit financiar jobankë, institucionit financiar të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike, duhet të plotësojnë të paktën kriteret e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë universitare ose minimalisht të kenë kryer programin e ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë (në rastin e administratorëve, shtetas shqiptarë), si rregull në ekonomi ose jurisprudencë;

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se 5 (pesë) vjet nga të cilat 3 vjet përvojë në sektorin bankar dhe/ose financiar ose në ndonjë fushë tjetër të konsideruar të përshtatshme nga Banka e Shqipërisë;

c) të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional;

d) të mos kenë shkaktuar ose të mos kenë qenë përgjegjës për falimentimin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;

e) të mos jenë në ndjekje penale ose të mos jenë shpallur fajtorë nga gjykata për një vepër penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;

f) të mos kenë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ose falimentimit, si dhe të jenë të çliruar nga pagesa e detyrimeve pasurore të kaluara;

g) të mos jenë ndëshkuar nga Banka e Shqipërisë gjatë 5 (pesë) vjetëve të fundit për shkelje të rëndë të ligjit për bankat ose për zhvillim të veprimtarisë pa licencën përkatëse të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 10

Kriteret për dhënien ose refuzimin e licencës

1. Banka e Shqipërisë merr vendim për dhënien e licencës vetëm kur krijon bindjen se subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje, përsa i përket kushteve të mëposhtme:

a) themeluesit e subjektit të kenë reputacion të mirë, burim të ligjshëm të kontributeve në kapital, veprimtari të ligjshme, të regjistruar dhe që mund të mbikëqyret, të kenë mundësi financiare për derdhjen e fondeve shtesë në qoftë se kapitali bie nën nivelin minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë ose për realizimin e financimeve të nevojshme për vazhdimin e qëndrueshëm në kohë të veprimtarisë së subjektit;

b) kualifikimet, përvoja e reputacioni i administratorit dhe i themeluesve me pjesëmarrje influencuese të jenë të përshtatshme për realizimin e planit të biznesit, në bazë të të cilit ato licencohen;

c) strukturat operationale dhe të kontrollit, përfshirë politikat dhe procedurat e subjektit financiar jobankë, të institucionit financiar të mikrokredisë ose të institucionit të parasë elektronike, të reflektojnë qëllimin dhe shkallën e plotësimit të veprimtarive të propozuara për t'u kryer prej tyre;

d) plani i biznesit i paraqitur të jetë real dhe konkurrues në treg, dhe gjendja e pritshme financiare e subjektit financiar jobankë, institucionit financiar të mikrokredisë ose e institucionit të parasë elektronike të propozuar të jetë e kënaqshme.

2. Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës kur nuk plotësohen kërkesat e kësaj rregulloreje, në rastet e mëposhtme:



- a) nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni;
- b) të paktën njëri nga administratorët ose themeluesit me pjesëmarrje influencuese ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ose falimentimit;
- c) nuk paraqitet informacion lidhur me identitetin e themeluesve me pjesëmarrje influencuese;
- d) vërtetohet se të paktën njëri nga themeluesit:
 - i) është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;
 - ii) është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizimit, dhe
 - iii) kur ndaj tij është marrë vendimi nga gjykata për moslejimin e ushtrimit të profesionit;
- e) nuk plotësohet informacioni shtesë i kërkuar nga Banka e Shqipërisë, sipas nenit 11 paragrafi 4 i kësaj rregulloreje;
- f) nuk zotëron shumën e kapitalit fillestar minimal, të kërkuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari financiare.

3. Banka e Shqipërisë, për të kryer vlerësimet e parashikuara në këtë nen, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave; organet e tatim taksave; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Autoriteti i Konkurrencës etj.

4. Banka e Shqipërisë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, i njofton subjektin vendimin për dhënien e licencës ose e njofton atë me shkrim mbi refuzimin e dhënies së saj, të shoqëruar me arsyet përkatëse.

Neni 11

Procedurat dhe afatet për shqyrtimin e kërkesës për licencim

1. Banka e Shqipërisë bën shqyrtimin e dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon dhënien e licencës si subjekt financiar jobankë, si institucion mikrokredie ose si institucion i parasë elektronike, brenda 2 (dy) muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë.

3. Data e pranimit të kërkesës për licencë, konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim kërkuetit, nga Banka e Shqipërisë.

4. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune do të dërgojë një njoftim për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e kësaj rregulloreje, së bashku me kërkesën për informacion ose dokumentacion shtesë.

5. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencë në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga subjekti brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për licencë. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencë Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin.

6. Banka e Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë sipas kërkesave të parashikuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje, si dhe pas plotësimit të informacionit shtesë sipas paragrafit 4 të këtij neni:

- a) shqyrton dhe analizon dokumentacionin e paraqitur;
- b) vlerëson aftësinë profesionale të administratorëve;

c) organizon nëse e çmon të nevojshme takime me administratorët e subjektit financiar jobankë, institucionit të mikrokredisë ose të institucionit të parasë elektronike, për të diskutuar planbiznesin e paraqitur dhe probleme të tjera të lidhura me veprimtarinë e propozuar të subjektit.

7. Banka e Shqipërisë mund të inspektojë mjediset/zyrat ku do të zhvillohet veprimtaria financiare, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e këtyre veprimtarive, në zbatim të akteve nënligjore të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 12

Botimi i vendimit për dhënien e licencës

1. Banka e Shqipërisë publikon vendimin për dhënien e licencës për të vepruar si subjekt financiar jobankë, institucion financiar i mikrokredisë ose institucion i parasë elektronike.

2. Vendimi botohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë regjistron në regjistrin e subjekteve financiare jobanka të dhëna lidhur me agjentët e këtyre të fundit.

Neni 13

Komisionet

1. Subjekti që kërkon dhënien e licencës për të vepruar si subjekt financiar jobankë, institucion financiar i mikrokredisë ose institucion i parasë elektronike paguan një komision për përpunimin e kërkesës për licencë prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh në Bankën e Shqipërisë, në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës.

2. Komisioni, i përcaktuar në këtë nen, nuk rimbursohet edhe në rast të refuzimit të dhënies së licencës nga Banka e Shqipërisë.

Neni 14

Pezullimi ose revokimi i licencës

1. Banka e Shqipërisë mund të pezullojë ose të revokojë licencën e subjektit financiar jobankë, të institucionit financiar të mikrokredisë ose të institucionit të parasë elektronike, në rast se:

a) kërkohet nga vetë subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike, i licencuar;

b) ekzistojnë të dhëna të besueshme se themeluesit ose administratorët janë përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;

c) ka shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, për shkak të të cilave subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike ka pësuar një humbje të ndjeshme financiare ose ka filluar procesi i falimentimit;

d) subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike nuk ekzekuton urdhrat për ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje, si dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave ligjore dhe nënligjore;

e) ka shkelje të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe si rezultat nuk arrihet të përcaktohet gjendja financiare e subjektit;

f) subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike pengon, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve, përmbushjen e funksionit mbikëqyrës nga Banka e Shqipërisë;

g) licenca është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë, pavarësisht nëse është dhënë nga subjekti apo ka të bëjë me subjektin, duke përfshirë të dhënat për kualifikimet, përvojën ose reputacionin e administratorëve dhe të themeluesve me pjesëmarrje influencuese të propozuar ose parregullsi të tjera për fakte të rëndësishme që lidhen me shqyrtimin e kërkesës për licencë;



- h) nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar;
 - i) nuk fillon veprimtarinë brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja e licencës ose ndërpret ushtrimin e veprimtarisë për më shumë se 3 (tre) muaj;
 - j) subjekti ka pushuar së ekzistuari si person juridik;
 - k) institucioni financiar i mikrokredisë nuk plotëson më kriteret e kësaj rregulloreje për t'u karakterizuar si i tillë, për një periudhë prej jo më pak se 3 (tre) muajsh.
2. Vendimi për pezullimin ose revokimin e licencës i komunikohet menjëherë me shkrim, subjektit financiar jobankë, institucionit financiar të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike, duke dhënë dhe arsyet përkatëse.
3. Vendimi i pezullimit ose revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
4. Subjekti ndalohet të kryejë veprimtaritë e parashikuara në licencën e tij pas hyrjes në fuqi të vendimit të Bankës së Shqipërisë për revokimin e saj ose për aq kohë sa zgjat shkak apo afati i pezullimit.

Neni 15

Botimi i vendimit për pezullimin ose revokimin e licencës

1. Banka e Shqipërisë publikon vendimin për pezullimin ose revokimin e licencës për të vepruar si subjekt financiar jobankë, institucion financiar i mikrokredisë ose institucion i parasë elektronike.
2. Vendimi botohet në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

NËNKREU I

Neni 16

Miratimet paraprake

1. Subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike, pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, nuk mund:
 - a) të ushtrojë veprimtari financiare të papërfshira në licencën e dhënë;
 - b) të zvogëlojë kapitalin;
 - c) të emërojë një ose disa administratorë;
 - d) të transferojë pronësinë e një ortakut ose aksioneri me pjesëmarrje influencuese ose kontrollin e subjektit.
2. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon miratimin paraprak, sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda 2 (dy) muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në nenin 17 të kësaj rregulloreje.

Neni 17

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për miratimet paraprake

1. Subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike, për të marrë miratimet paraprake të parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "d" të nenit 16 të kësaj rregulloreje, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) për zvogëlimin e kapitalit:
 - i) vendimin e asamblesë për zvogëlimin e kapitalit; dhe
 - ii) relacionin shoqërues me arsyet e këtij ndryshimi.
 - b) për të emëruar administratorin/ët:

i) vendimin e strukturës vendimmarrëse për emërimin e administratorit/ëve,
ii) dokumentacionin sipas nenit 8, paragrafi 2, shkronjat “f” dhe “j”, të kësaj rregulloreje;
c) për transferimin e pronësisë së një ortaku ose aksioneri me pjesëmarrje influencuese ose për transferimin e kontrollit të subjektit:

i) vendimin e asamblesë për miratimin e këtij ndryshimi;
ii) dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, paragrafi 2, shkronjat “e”, “f”, “g” “h” dhe “i” të kësaj rregulloreje; dhe
iii) kopje të aktmarrëveshjes së nënshkruar për ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese ose kontrollit të subjektit.

2. Banka e Shqipërisë sipas rastit mund të kërkojë edhe dokumente shtesë përveç sa është parashikuar në këtë nen.

3. Banka e Shqipërisë, për të kryer vlerësimet e parashikuara në këtë nen, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave, organet e tatim taksave, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës etj.

NËNKREU II

Neni 18

Veprimtaritë shtesë

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, subjekti financiar jobankë ka të drejtë t'i kërkojë Bankës së Shqipërisë, të lejohet të kryejë veprimtari të tjera financiare, të papërfshira në licencën e dhënë, duke plotësuar kërkesat e nenit 6 dhe nenit 19 të kësaj rregulloreje.

Neni 19

Dokumentacioni për miratimin e veprimtarisë shtesë

1. Kërkesa për të ushtruar veprimtari shtesë, bëhet me shkrim nga administratori i subjektit ose një person i autorizuar ligjërisht prej tij dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) vendimi i organit vendimmarrës të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë shtesë;
- b) ekstrakti i Regjistrimit Tregtar, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria/të shtesë në objektin e shoqërisë;
- c) dokumenti që vërteton pagimin e shtesës së shumës të kapitalit fillestar minimal, në qoftë se kapitali i llogaritur nuk plotëson kërkesën për kapital për veprimtarinë që kërkon të kryejë subjekti, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- d) informacioni mbi plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë, sipas rregullores “Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, për kryerjen e veprimtarisë shtesë, në rast se kjo e fundit është veprimtari me sportel;
- e) rregulloret dhe/ose manualet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë shtesë;
- f) parashikimin për 3 (tre) vitet e ardhshme të treguesve financiarë për veprimtarinë/të shtesë dhe ndikimin e tyre në gjendjen e përgjithshme financiare të subjektit.

2. Dokumentacioni sipas paragrafit 1 këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni të jetë dhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

3. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.



Neni 20

Shqyrtimi i kërkesës për veprimtari shtesë

1. Banka e Shqipërisë bën shqyrtimin e plotësimit të kërkesës për kapital dhe dokumentacionit për ushtrimin e veprimtarive financiare shtesë, në përputhje me kërkesat e neneve 6 dhe 19 të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë, brenda 2 (dy) muajve nga paraqitja e dokumentacionit të plotë, jep miratimin për kryerjen e veprimtarive shtesë nëse vlerëson se këto veprimtari nuk vënë në rrezik qëndrueshmërinë financiare të subjektit financiar jobankë dhe plotësohen kushtet teknike për ushtrimin e sigurt të tyre.

3. Në rastin e refuzimit të kërkesës për të ushtruar veprimtari shtesë, Banka e Shqipërisë jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.

NËNKREU III

Neni 21

Kërkesat mbi detyrimet për njoftim

1. Subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike, njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë në rastet kur:

a) pozicionet e rrezikut arrijnë kufijtë maksimalë të lejuar të ekspozimit, sipas akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

b) vlerësohet se ka shkaqe të justifikuara për ndërprerjen ose pezullimin e ndonjë veprimtarie financiare të lejuar;

c) vlerësohet se ka shkaqe për revokimin e licencës;

d) kur institucioni financiar i mikrokredisë gjatë veprimtarisë së tij nuk plotëson më të paktën një nga karakteristikat e përcaktuara në nenin 4, paragrafi 3, shkronja “b” të kësaj rregulloreje.

2. Subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike, njofton Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve për:

a) ndryshimin e emrit;

b) ndryshimin e statutit;

c) zmadhimin e kapitalit;

d) ndryshimet në strukturën e kapitalit aksioner, që nuk janë subjekt i miratimit paraprak sipas kësaj rregulloreje;

e) ndryshime në strukturën organizative;

f) hapjen ose mbylljen e degëve të subjektit apo ndryshime të adresës së tyre;

g) ndryshim të selisë dhe adresës së tij apo të selisë dhe adresës së agjentëve të subjektit financiar jobankë ose të institucionit të parasë elektronike;

h) largimin e administratorëve;

i) listën e agjentëve të tij apo ndryshime të saj;

j) çdo ndryshim tjetër që është i detyrueshëm për regjistrim në regjistrin tregtar; dhe

k) për të gjitha shtesat në listën e produkteve, të transaksioneve financiare dhe kanaleve të komunikimit që kryhen në rrugë elektronike, të cilat ndodhin pas fillimit të veprimtarisë së subjektit, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) procedurat e funksionimit dhe të dhënat teknike për transaksionet financiare që kryhen në rrugë elektronike dhe programi i kontrollit të brendshëm për këtë qëllim;

b) marrëveshja e nënshkruar me shoqërinë, për realizimin e mbështetjes informatike të aktivitetit të subjektit, nëse ka të tillë, ose nëse ndryshon pas marrjes së autorizimit;

c) listën sqaruese të transaksioneve financiare që do të kryejë subjekti së bashku me kanalet e komunikimit që do të përdoren.

KREU III MIRATIMI I AGJENTIT

Neni 22

Veprimtaritë financiare të agjentit

1. Subjekti financiar jobankë mund të ushtrojë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe transferimit të parave, nëpërmjet një ose më shumë agjentëve.

2. Agjenti për ushtrimin e veprimtarisë financiare të shërbimeve të pagesave dhe transferimit të parave merr miratimin e Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur si agjent është një bankë ose degë e bankës së huaj, e licencuar nga Banka e Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë mbikëqyr agjentët në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së transferimit të parave.

4. Institucioni i parasë elektronike nuk mund të emetojë para elektronike nëpërmjet agjentëve.

5. Institucioni i parasë elektronike mund të shpërndajë dhe/ose të ripaguajë fondet, nëpërmjet një ose më shumë agjentëve, të cilët veprojnë për llogari të tij.

Neni 23

Dokumentacioni për miratimin e agjentit

1. Kërkesa për miratimin e agjentit për të ushtruar veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, në emër dhe për llogari të subjektit financiar jobankë, bëhet me shkrim nga administratori i agjentit ose një person i autorizuar ligjërisht prej tij dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) dokumentacioni me të dhënat identifikuese për agjentin, si më poshtë:

ii) ekstrakti i Regjistrimit Tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria që agjenti kërkon të ushtrojë; dhe dokumenti se nuk është në procedurë likuidimi apo falimentimi;

b) kontrata e agjencisë, e lidhur ndërmjet agjentit dhe subjektit financiar jobankë/institucionit të parasë elektronike, ku të jenë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet respektive, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë financiare;

c) vërtetimet e mëposhtme, të lëshuara nga organet kompetente, sipas juridiksionit territorial për themeluesit dhe administratorin e agjentit:

i) se personi nuk është në ndjekje penale;

ii) se personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii) se personi nuk është i dënuar penalisht; dhe

iv) se personi nuk është në procedurë ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes në Bankën e Shqipërisë;

d) informacion mbi mjediset dhe kushtet teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë financiare;

e) informacion mbi mënyrën e regjistrimit dhe ruajtjes në një regjistër të posaçëm të të gjitha transaksioneve në ushtrimin e veprimtarisë që kryen në emër dhe për llogari të subjektit financiar jobankë;



f) vërtetimi nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë, që subjekti ka bllokuar në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 6, paragrafi 3 të kësaj rregulloreje. Kjo shumë, zhblokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës së Shqipërisë, në përfundim të procedurës së licencimit.

2. Dokumentacioni sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni të jetë dhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

3. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 24

Shqyrtimi i kërkesës për miratimin e agjentit

1. Banka e Shqipërisë bën shqyrtimin e plotësimit të dokumenteve të paraqitura lidhur me kërkesën për miratim të agjentit, në përputhje me kërkesat e nenit 23 të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë, brenda 1 (një) muaji nga paraqitja e dokumentacionit të plotë sipas nenit 23 dhe plotësimit të kërkesës për kapital sipas paragrafit 3 të nenit 6 të kësaj rregulloreje, jep ose refuzon miratimin për agjentin për të ushtruar veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave.

3. Në rastin e refuzimit të kërkesës për miratimin e agjentit, Banka e Shqipërisë jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.

Neni 25

Revokimi i miratimit të agjentit

1. Banka e Shqipërisë revokon miratimin e agjentit të subjektit financiar jobankë në rast se:

- a) kërkohet nga vetë agjenti ose subjekti financiar jobankë;
- b) agjenti është përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;
- c) subjektit financiar jobankë i është pezulluar ose revokuar licenca;
- d) agjenti ushtron veprimtari financiare, për të cilat nuk ka marrë miratimin e Bankës së Shqipërisë;
- e) agjenti nuk ka aftësi paguese ose ndaj tij ka filluar procesi i falimentimit;
- f) kontrata ndërmjet agjentit dhe subjektit financiar jobankë është zgjidhur ose është e pavlefshme;
- g) agjenti ose subjekti financiar jobankë nuk ekzistojnë më si persona juridikë ose kanë humbur zotësinë për të vepruar;
- h) agjenti, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve, pengon ushtrimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë;
- i) miratimi është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë ose të pasaktë, që lidhet me shqyrtimin e kërkesës për miratim;
- j) nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave ai është miratuar;
- k) nuk fillon veprimtarinë brenda 3 (tre) muajve nga marrja e miratimit ose ndërpret ushtrimin e veprimtarisë për më tepër se 3 (tre) muaj;
- l) për çdo shkak tjetër që vlerësohet nga Banka e Shqipërisë.

2. Agjenti dhe/ose subjekti financiar jobankë detyrohen të njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë për faktet dhe/ose rrethanat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Vendimi për revokimin e miratimit i komunikohet menjëherë me shkrim agjentit dhe subjektit financiar jobankë ku jepen dhe arsyet.

4. Vendimi i revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

KREU IV
RIORGANIZIMI JURIDIK

NËNKREU I
BASHKIMI

Neni 26

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për bashkimin me përthithje

1. Subjekti financiar jobankë nuk mund të riorganizohet, nëpërmjet bashkimit me përthithje, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga subjekti financiar jobankë, përthithës dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së aksionerëve/ortakëve të secilit subjekt financiar jobankë, të përfshirë në operacion, për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit me përthithje;

b) marrëveshja/projekti dhe raporti i detajuar i operacionit të bashkimit me përthithje, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të subjekteve financiare jobanka, që marrin pjesë në bashkim. Marrëveshja dhe raporti hartohen me shkrim dhe në përputhje me kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionit tjetër të zbatueshëm;

c) projektstatuti i subjektit financiar jobankë, pas realizimit të operacionit të bashkimit me përthithje;

d) planet strategjike dhe operative për realizimin e përthithjes, në të cilat përfshihen analiza e nevojës së përthithjes dhe parashikime të raporteve financiare, për subjektin financiar jobankë përthithës, të përgatitura në përputhje me nenin 8, paragrafi 2, shkronja “k” të kësaj rregulloreje;

e) nëse do të ketë ndryshime në strukturën organizative të subjektit financiar jobankë përthithës, struktura e re organizative me përshkrim të veçantë të punës dhe të përgjegjësive të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, si dhe numri i mundshëm i punonjësve;

f) nëse ka ndryshime në administratorët e subjektit financiar jobankë përthithës, për këta do të paraqitet dokumentacioni sipas kërkesave të përcaktuara për administratorët në këtë rregullore;

g) struktura e re e aksionerëve të subjektit financiar jobankë përthithës, duke përfshirë aksionerët e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë;

h) bilanci i subjektit financiar jobankë përthithës dhe të dhëna të detajuara për kapitalin e vet, të përgatitura mbi baza të konsoliduara dhe të certifikuara nga një ekspert kontabël i autorizuar.

Neni 27

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për bashkimin me krijim

1. Subjekti financiar jobankë nuk mund të riorganizohet, nëpërmjet bashkimit me krijim, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga subjektet financiare jobanka ekzistuese dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së aksionerëve/ortakëve të secilit subjekt financiar jobankë të përfshirë në operacion për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit me krijim;

b) marrëveshja/projekti dhe raporti i detajuar i operacionit të bashkimit i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të subjekteve financiare jobanka që bashkohen, të cilët duhet të përmbushin kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionit tjetër të zbatueshëm;

c) raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projekt marrëveshjes së bashkimit;



d) bilanci i subjektit financiar jobankë të ri, me të dhëna të detajuara për kapitalin aksioner të vet, të përgatitura mbi baza të konsoliduara dhe të certifikuara nga një ekspert kontabël i autorizuar.

NËNKREU II NDARJA

Neni 28

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për ndarjen me krijim

1. Subjekti financiar jobankë nuk mund të riorganizohet, nëpërmjet ndarjes me krijim, pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga subjekti financiar jobankë që po ndahet dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së aksionerëve/ortakëve të subjektit financiar jobankë, që po ndahet, për miratimin e operacionit të riorganizimit nëpërmjet ndarjes me krijim;

b) marrëveshja/projekti dhe raporti i detajuar i operacionit të ndarjes, i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të subjekteve financiare jobanka, të përfshira në këtë operacion, i cili përgatitet në përputhje me kërkesat e përshkruara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm;

c) bilanci e subjekteve financiare jobanka të reja pritëse me të dhëna të detajuara mbi kapitalin e vet;

d) nëse kapitali i subjekti financiar jobankë që ndahet nuk plotëson minimumin e kapitalit fillestar të kërkuar për subjektet financiare jobanka pritëse, që përfitohen nga procesi i ndarjes, depozitohen fonde të nevojshme shtesë në një llogari bankare.

Neni 29

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për ndarjen me përthithje

1. Subjekti financiar jobankë nuk mund të riorganizohet nëpërmjet ndarjes me përthithje pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga subjekti financiar jobankë që ndahet dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së aksionerëve/ortakëve të secilit subjekt financiar jobankë të përfshirë në operacion, për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet ndarjes me përthithje;

b) marrëveshja/projekti dhe raporti i detajuar i operacionit të ndarjes, i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të subjekteve financiare jobanka të përfshira në këtë operacion, të cilët përgatiten në përputhje me kërkesat e përshkruara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm;

c) plani strategjik dhe operacional për realizimin e ndarjes, i cili përfshin analizat e nevojshmërisë së ndarjes dhe parashikime të raporteve financiare, të përgatitura për bankën, që ndahet dhe për subjektet financiare jobanka pritëse;

d) struktura e re organizative e subjekteve financiare jobanka pritëse, me përshkrim të veçantë të punës dhe të përgjegjësive të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe numri i mundshëm i punonjësve;

e) bilanci e subjektit financiar jobankë që ndahet dhe të subjekteve financiare jobanka pritëse me të dhëna të detajuara të kapitalit të vet. Bilancet përgatiten mbi baza të konsoliduara dhe certifikohen nga një ekspert kontabël i autorizuar;

f) struktura e re e aksionerëve të subjekteve financiare jobanka pritëse, duke përfshirë aksionarët e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, nëse pas ndarjes ka ndryshime në strukturën e aksionarëve të subjekteve financiare jobanka;

g) të dhënat e përcaktuara në nenin 8 paragrafi 2, shkronja “k” të kësaj rregulloreje për biznesplanin e subjekteve financiare jobanka pritëse.

Neni 30

Të përgjithshme për bashkimin dhe ndarjen

1. Në rastet kur bashkimet dhe ndarjet çojnë në krijimin e, të paktën, një subjekti financiar jobankë të ri, ky i fundit do t’i nënshtrohet të gjitha rregullave të përcaktuara në këtë rregullore për licencimin rishtazi si subjekt financiar jobankë.

2. Banka e Shqipërisë, pas marrjes së kërkesës për miratimin e bashkimit/ndarjes, publikon njoftimin përkatës, në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë, për kërkesën e paraqitur nga ana e subjektit financiar jobankë.

3. Banka e Shqipërisë përveç dokumentacionit të përcaktuar në këtë rregullore, mund të kërkojë, rast pas rasti, edhe informacione të tjera shtesë, të cilat i gjykon të nevojshme në procesin e vendimmarrjes, nisur nga veçoritë (specifikat) e këtij procesi.

4. Banka e Shqipërisë, pasi shqyrton dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur, merr vendimin për miratimin ose refuzimin e riorganizimit të subjektit financiar jobankë.

5. Banka e Shqipërisë miraton ato bashkime/ndarje, që përveç sa përcaktohet në këtë rregullore, nuk shkelin detyrimet ligjore lidhur me mbrojtjen e konkurrencës në tregun financiar dhe nuk rrezikojnë pozicionin e kreditorëve.

6. Afati maksimal për shqyrtimin e dokumentacionit dhe për miratimin ose për refuzimin e bashkimit/ndarjes është 3 (tre) muaj nga depozitimi i dokumentacionit të plotë, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

7. Në rastin e bashkimit me përthithje, subjekti financiar jobankë përthithës vazhdon të ushtrojë vetëm veprimtaritë financiare për të cilat është licencuar.

8. Në rastin e ndarjes me përthithje subjektet financiare jobanka pritëse vazhdojnë të ushtrojnë vetëm veprimtaritë financiare për të cilat janë licencuar.

9. Në rastet e veçanta të bashkimit me përthithje, të parashikuara në nenin 225 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dokumentacioni i kërkuar për miratimin e riorganizimit do të jetë në përputhje me përcaktimet e këtij neni.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31

Të tjera

1. Të gjitha shoqëritë tregtare që kërkojnë të zgjerojnë veprimtarinë e tyre, duke kryer edhe një ose disa nga veprimtaritë e përshkruara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, kanë të drejtë të paraqesin në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin përkatës për licencim.

2. Për shoqëritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shuma e kapitalit fillestar minimal në lidhje me veprimtaritë e parashikuara në nenin 5 që subjekti parashikon të kryejë, do të konsiderohet kapitali i llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse të Bankës së Shqipërisë për mbikëqyrjen e subjekteve financiare jobanka, me të dhënat e certifikuara nga eksperti kontabël i autorizuar.



3. Subjektet financiare jobanka, në rast të plotësimit të karakteristikave të institucionit financiar të mikrokredisë/institucionit të parasë elektronike të përcaktuara në këtë rregullore, kanë të drejtë të kërkojnë të licencohen si institucione financiare të mikrokredisë/institucione të parasë elektronike, në përputhje me kërkesat e parashikuara në këtë rregullore. Banka e Shqipërisë kur licencën subjektin si institucion financiar të mikrokredisë/institucion të parasë elektronike, revokon njëkohësisht licencën ekzistuese si subjekt financiar jobankë.

4. Institucioni i parasë elektronike, përveç emetimit të parasë elektronike, mund të ushtrojë edhe një ose disa nga veprimtaritë financiare të mëposhtme:

- i) të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave,
- ii) këmbimin valutor; si dhe
- iii) shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtaritë financiare për të cilat është licencuar.

Neni 32

Dispozitë kalimtare

1. Subjektet financiare jobanka të licencuara nga Banka e Shqipërisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të konsiderohen të licencuara sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, në përputhje me aktivitetet financiare të përcaktuara në licencën ekzistuese.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i paragrafit 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'u kërkojë subjekteve të licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, informacione shtesë nëse vlerëson se informacioni i paraqitur në kohën e marrjes së licencës nuk është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 33

Të fundit

Formularët bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

**KËRKESË
DREJTUAR
BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR DHËNIE LICENCE
PËR SUBJEKT FINANCIAR JOBANKË / INSTITUCION FINANCIAR
MIKROKREDIE/INSTITUCION I PARASË ELEKTRONIKE**

Emri i subjektit : _____
Vendndodhja e propozuar : adresa _____, Shqipëri
(qyteti) (rrethi)

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari (lista e veprimtarive) si subjekt financiar jobankë/institucion financiar mikrokredie/institucion i parasë elektronike.

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë, angazhohemi për zbatimin e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të legjislacionit shqiptar.

Kërkuesit

P.s. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme:

Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Rruga e Dibrës, kompleksi “Halili”
Tiranë, Shqipëri

Formulari nr. 1

VENDIMI

I -----
(ORGANIT VENDIMMARRËS)

PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE

----- (organi vendimmarrës) vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, ----- (organi vendimmarrës) emëron dhe përcakton si përfaqësues:

(emri) (atësia) (mbiemri)

Adresa: _____
(rruga, numri) (qyteti) (shteti)

(numri i telefonit)

(numri i faksit/teleksit)

Përfaqësuesi i mësipërm është i autorizuar të përfaqësojë subjektin dhe të paraqitet të nënshkruajë para Bankës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e ----- (organit vendimmarrës). Përfaqësuesi është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbushë të gjitha synimet dhe qëllimet siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari, nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Banka e Shqipërisë.

Datë _____,

(emri, mbiemri)

(nënshkrimi)

Shënim. Ky formular duhet të vërtetohet nga noteri.



PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(të realizuara nga veprimtaria financiare)

PARAQITET PËR 3 VITET E PARA TË AKTIVITETIT

TË ARDHURAT	VITI I	VITI II	VITI III
-------------	--------	---------	----------

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

TOTALI I TË ARDHURAVE _____ Lekë

SHPENZIMET	VITI I	VITI II	VITI III
------------	--------	---------	----------

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

TOTALI I SHPENZIMEVE _____ Lekë

TË ARDHURAT NETO PARA TAKSAVE _____ lekë

ADMINISTRATORËT

Emri i subjektit financiar jobankë / institucionit financiar të mikrokredisë/institucionit të parasë elektronike:

Emri e mbiemri i administratorit	Adresa e banimit të administratorit	Detyra	Numri i kuotave që zotëron në kapital	Përqindja ndaj totalit
TOTALI				

¹ Në qoftë se zotëron.



CURRICULUM VITAE
(i administratorit të propozuar, ortakut/aksionerit individ)

Emri dhe mbiemri	
Adresa e banimit	
Datëlindja	
Vendlindja	
Shtetësia	
Numri i telefonit të punës	
Numri i telefonit celular	
Adresa e-mail	
KUALIFIKIMI ARSIMOR	
(Lutemi listoni në mënyrë kronologjike të gjitha institucionet arsimore që keni ndjekur, kohëzgjatjen e studimeve, datën e diplomimit dhe titujt/gradat akademike)	
1. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	
Diploma e fituar	
2. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	
Diploma e fituar	
NIVELI I NJOHJES SË GJUHËVE TË HUAJA	
(Lutemi listoni gjuhët dhe nivelin e njohjes së tyre me numrat nga 5 - 1 (5 = shumë mirë, 4 = mirë, 3 = mjaftueshëm etj.)	
TRAJNIME TË AVANCUARA	
(Lutemi listoni në mënyrë kronologjike të gjitha kurset, periudhat, temat e kursit, organizatorët)	
PJESËMARRJE NË KËSHILLA DREJTUESE/ NË SHOQATA PROFESIONISTËSH	
(Lutemi listoni shoqëritë/shoqatat ku jeni ose keni qenë anëtar i këshillave drejtues, datat e pjesëmarrjes, etj.)	
EKSPERIENCA NË PUNË	
(Lutemi listoni në mënyrë kronologjike të gjitha punësimet, duke filluar nga punësimi më i fundit, titullin e pozicionit dhe kohëzgjatjen e punësimit si dhe përgjegjësitë të detajuara për secilin pozicion)	
1. Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Periudha e punësimit (muaj/vit - muaj/vit)	
Natyra e punësimit	a. i punësuar !__! b. i vetëpunësuar !__! c. i papunë !__! d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time) ! !
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë e pozicionit të punës (të detajuara)	
Arsyet e largimit	Dorëheqje !__! Shkurtim i vendit të punës !__! Dalje në pension !__! Përfundim i kontratës !__! Pushim nga puna !__! Të tjera !__! Specifiko
2. Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Periudha e punësimit (muaj/vit - muaj/vit)	

Natyra e punësimit	a. i punësuar !__! b. i vetëpunësuar !__! c. i papunë !__! d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time) ! !
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë e pozicionit të punës (të detajuara)	
Arsyet e largimit	Dorëheqje !__! Shkurtim i vendit të punës !__! Dalje në pension !__! Përfundimi i kontratës !__! Pushim nga puna !__! Të tjera !__! Specifiko
3. Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyra e punësimit	a. i punësuar !__! b. i vetëpunësuar !__! c. i papunë !__! d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time) ! !
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë e pozicionit të punës (të detajuara)	
Arsyet e largimit	Dorëheqje !__! Shkurtim i vendit të punës !__! Dalje në pension !__! Përfundimi i kontratës !__! Pushim nga puna !__! Të tjera !__! Specifiko
4. Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyra e punësimit	a. i punësuar !__! b. i vetëpunësuar !__! c. i papunë !__! d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time) ! !
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë e pozicionit të punës (të detajuara)	
Arsyet e largimit	Dorëheqje !__! Shkurtim i vendit të punës !__! Dalje në pension !__! Përfundimi i kontratës !__! Pushim nga puna !__! Të tjera !__! Specifiko

Emri dhe mbiemri

(firma)

Data



DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se informacioni i paraqitur këtu, me sa di dhe besoj, është i vërtetë dhe i saktë. Ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht Bankës së Shqipërisë nga ana ime.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport, mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë kërkesën.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Data)

(nënshkrimi i plotë)

Në qoftë se është i zbatueshëm:

(nënshkrimi i përgatitësit)

Nënshkruar në këtë ditë _____ të _____, 20 ____.

(Nënshkrimi i noterit publik)

Shënim. Do të plotësohet nga çdo themelues.

AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL
(Të plotësohet secili prej të dy formularëve të autorizimit në origjinal!)

Unë _____ autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firmë, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër për personin tim, t'i paraqesë origjinalin ose kopje të këtij dokumenti, regjistri ose informacioni Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data /muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time
_____ data _____, 20 _____

**KY DOKUMENT ËSHTË I VLEFSHËM
PËR 6 MUAJ _____**

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

Unë _____ autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firmë, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër për personin tim, t'i paraqesë origjinalin ose kopje të këtij dokumenti, regjistri ose informacioni Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data/muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time
_____ data _____, 20 _____

**KY DOKUMENT ËSHTË I
VLEFSHËM PËR 6 MUAJ _____**

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

Shënim. Do të plotësohet nga çdo themelues.



MJEDISËT E SUBJEKTIT DHE VENDNDODHJA E TIJ ²

1. Kapitali i propozuar për t'u investuar në mjete fikse, tipi i zotërimit:
 - Vendet e përhershme të marra me qira;
 - Vendet e përhershme pronë vetjake;
 - Vendet e përkohshme.
2. Përshkrimi i mjediseve:
 - a) Mjediset që do të merren me qira:
 - i) kostoja vjetore e parashikuar e qirasë së subjektit financiar jobankë;
 - ii) përshkrimi i riparimeve dhe i përmirësimeve të parashikuara të ndërtesës.
 - b) Mjediset në pronësi:
 - i) emri dhe adresa e shitësit, data e përfundimit të ndërtimit, kostoja e blerjes së lokalit (objektit);
 - ii) kostoja dhe përshkrimi i riparimeve të nevojshme, riparime dhe ndryshime të ndërtesës dhe të ambientit rrethues.
 - c) Vendet e përkohshme:
 - i) vendndodhja e mjediseve të përkohshme;
 - ii) detaje lidhur me mjediset e përkohshme, duke përfshirë përmasat e tyre, tipin e konstruksionit, lehtësitë më kryesore që do të vendosen në ndërtesë;
 - iii) në qoftë se mjediset e përkohshme do të blihen, parashikimin e kostos, vlerën e përafërt të rishitjes, një kopje të formularit-tip të kontratës së blerjes;
 - iv) në qoftë se mjediset e përkohshme do të merren me qira, të jepet parashikimi i vlerës së qirasë mujore.
3. Investimi i propozuar në mobilie, në pajisje dhe një përshkrim i sendeve.
4. Investimi i propozuar për të përmbushur kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

² Shënim. Siguroni sa më shumë të jetë e mundur nga ky informacion në kohën e paraqitjes së kërkesës. Pjesa tjetër e informacionit të dorëzohet në Bankën e Shqipërisë para marrjes së licencës përfundimtare.

INFORMACION PËR THEMELUESIT E SHOQËRISË

Themeluesi	Forma juridike	Adresa	Kombësia, shtetësia	Shuma e kapitalit të zotëruar (lekë)	Përqindja ndaj totalit



PLANI I VEPRIMTARISË SË PROPOZUAR

Plani i veprimtarisë duhet të përcaktojë qëllimin, objektivat dhe filozofinë e biznesit të subjektit. Banka e Shqipërisë do të rishikojë vazhdimisht gjatë vitit të parë të veprimtarisë, planin e propozuar të veprimtarisë, që nga miratimi për të gjykuar nëse operacionet e subjektit financiar jobankë, institucionit financiar të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike kryhen në përputhje me planin fillestar të dhënë të veprimtarisë, veçanërisht për sa i përket rritjes së aktiveve dhe detyrimeve. Çdo ndryshim i rëndësishëm i planit fillestar të paraqitur mund të bëhet shkak për revokimin e licencës. Për këtë arsye, duhet pasur kujdes për përgatitjen e planit të veprimtarisë.

Në planin e veprimtarisë:

1. Prezantohet struktura e organizimit të shoqërisë.
2. Përshkruhen politikat e subjektit për veprimtaritë që kërkon të kryejë, objektivat dhe pozicioni i tij në treg.
3. Përshkruhen veprimtaritë, segmenti i tregut (klientela), produktet dhe shërbimet që propozon të kryejë gjatë 3 (tre) viteve të para të veprimtarisë.
4. Përshkruhen, të detajuara, burimet e financimit dhe struktura e aktiveve për 3 (tre) vitet e para të aktivitetit. Tregohet deri në çfarë shkalle subjekti jobankë do të japë hua ose do të marrë pjesë në hua, jashtë zonës kryesore ku kryen shërbimet financiare.
5. Përshkruhen vlerësimi i tregut, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij.
6. Përshkruhet parashikimi i gjendjes financiare të subjektit për 3 (tre) vitet e para pas licencimit të veprimtarisë së tij, pasqyrat financiare.
7. Prezantohet një informacion, sipas formularit 7 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, lidhur me mjediset ku subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë parashikon të kryejë veprimtarin/të.
8. Prezantohet një informacion për investimet në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, i shoqëruar me listën e pajisjeve, programeve, etj.
9. Prezantohet një parashikim në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës (tregues të kujdesit, raporte etj.) për 3 (tre) vitet e ardhshëm.

Organi vendimmarrës duhet të shqyrtojë, të diskutojë dhe të miratojë kushtet e planit që mendohet të jetë me përfitim. Plani i biznesit mendohet të jetë një paraqitje e planeve dhe e parashikimeve të menduara prej organit vendimmarrës, për të qenë të arritshme dhe Banka e Shqipërisë mund të mbështetet në të, gjatë shqyrtimit për miratimin ose jo të kërkesës.

VENDIM

Nr. 2, datë 17.1.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve jobanka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 24.03.2010.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE FINANCIARE
JOBANKA

KREU I
TË PËRGIJITHSHME

Neni 1
Objkti

Objkti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 1, pika 4, shkronja “b”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili më poshtë në këtë rregullore do të quhet “Ligji për bankat”.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë subjektet financiare jobanka, institucionet financiare të mikrokredisë dhe institucionet e parasë elektronike, të licencuar për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë.



Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat dhe në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “Kapital” është shuma algjebrike e elementeve të mëposhtme të bilancit:

i) kapital i paguar,

ii) primet e aksioneve,

iii) rezervat,

iv) diferenca rivlerësimi,

v) fitimet e pashpërndara, dhe

vi) fitim-humbja e vitit ushtrimor;

b) “Kredi me probleme” është totali i kredisë (kryegjë dhe interes) të klasifikuar në tre kategoritë e fundit, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;

c) “Kredi me probleme neto” është totali i kredisë me probleme (kryegjë dhe interes), duke zbritur fondin rezervë të krijuar për mbulimin e humbjeve nga këto kredi;

d) “Tepricë mesatare e parasë elektronike” është shuma totale mesatare e detyrimeve financiare të lidhura me paranë elektronike të emtuar në fund të çdo dite kalendarike përgjatë një gjashtëmujori, të llogaritur në ditën e parë kalendarike të muajit pasardhës të gjashtëmujorit dhe që aplikohet për këtë muaj kalendarik.

e) “Ristrukturimi i kredisë” është lehtësimi/et që subjekti bën për kredimarrësin/it për shkak të vështirësive financiare të tyre, të shkaktuara nga arsye ekonomike ose ligjore, të cilat nuk bëhen nga subjekti në asnjë rast tjetër, dhe përfshijnë në përgjithësi:

i) lehtësimet e bëra në kushtet e kredisë, nëpërmjet ndryshimit të një ose disa kushteve të kontratës (duke përfshirë ndryshimin e produktit dhe kapitalizimin e interesit), të cilat lidhen kryesisht me afatin, kryegjënë dhe normën e interesit,

ii) marrjen (përdorimin) e kolateralit apo pasurive të tjera për shlyerjen e pjeshme të kredisë,

iii) zëvendësimin e kredimarrësit fillestar ose përfshirjen e një ose më shumë kredimarrësi shtesë.

KREU II ADMINISTRIMI I RREZIQEVE PËR TË GJITHA SUBJEKTET

NËNKREU I PARIMET DHE RREGULLAT BAZË TË DREJTIMIT TË PËRGJEGJSHËM DHE EFEKTIV

Neni 5 Organet drejtuese dhe kultura e përgjithshme e drejtimit

1. Organet drejtuese, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive që lidhen me drejtimin dhe kontrollin e subjektit, njohin në mënyrë të plotë dhe të qartë profilin e rrezikut të subjektit, duke përcaktuar/miratur paraprakisht ndërmarrjen dhe tolerancën ndaj tij (rrezikut), si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tij në përputhshmëri me këto të fundit, duke siguruar që nivelet e kapitalit të mbulojnë mjaftueshëm këtë rrezik.

2. Organet drejtuese, nëpërmjet mënyrës së drejtimit, nxisin (stimulojnë) një kulturë të përshtatshme drejtimi, e cila ka si përparësi ndershmërinë dhe krijimin e marrëdhënieve korrekte ndërmjet nëpunësve, të bazuar në standarde të larta profesionale dhe vlera të larta etike.

3. Organet drejtuese marrin masa për arritjen e standardeve të larta etike dhe profesionale në drejtimin e subjektit.

Neni 6

Sistemi i administrimit të rrezikut

1. Subjektet krijojnë dhe zhvillojnë sistemin për administrimin e rrezikut, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre.

2. Sistemi i administrimit të rrezikut është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të subjekteve, që shërbejnë për administrimin e rrezikut.

NËNKREU II

EKSPOZIMI MAKSIMAL I LEJUESHËM

Neni 7

Kufizimet maksimale të lejueshme të ekspozimit të madh

1. Ekspozimi i subjektit ndaj një personi ose një pale të tretë është shuma e të gjitha marrëdhënieve në aktiv të bilancit dhe të angazhimeve jashtë bilancit me këtë person ose kundërpartit, dhe personave të lidhur me të.

2. Ekspozimi i subjektit, me përjashtim të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e qirasë financiare, ndaj një personi ose grupi personash të lidhur konsiderohet ekspozim i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 10% (dhjetë për qind) e kapitalit të subjektit.

3. Ekspozimi i subjektit ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, nuk mund të tejkalojë 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të kapitalit të subjektit, me përjashtim të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e faktoringut, të qirasë financiare, dhe institucioneve të parasë elektronike.

4. Në ekspozimin e subjektit ndaj një personi nuk përfshihen:

a) pretendimet që rrjedhin nga marrëdhëniet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të siguruar me barrë siguroese mbi një depozitë monetare, deri në shumën e kësaj barre siguroese;

b) tituj të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose të Bankës së Shqipërisë apo një garanci e patjetërsueshme e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

5. Subjekti - me përjashtim të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e faktoringut, të qirasë financiare, dhe institucioneve të parasë elektronike - nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat të marra së bashku tejkalojnë 600% të kapitalit të subjektit.

Neni 8

Llogaritja e ekspozimeve të mëdha

1. Subjektet, për qëllime të llogaritjes, raportimit dhe respektimit të kufizimeve maksimale të lejueshme të ekspozimeve të mëdha, përfshijnë në shumën e reduktuar me 20% (njëzet për qind) të ekspozimit, të drejtat me afat deri në maturitet jo më shumë se 1(një) vit, ndaj bankave dhe institucioneve financiare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.

2. Subjektet hartojnë procedura të brendshme dhe kontabël, si dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm, për të identifikuar, regjistruar dhe monitoruar të gjitha ekspozimet e mëdha dhe ndryshimet e tyre.



Neni 9 **Rreziku i likuiditetit**

1. Rreziku i likuiditetit është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së aktiveve likuide të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet kur ato maturohen dhe kërkohen, dhe/ose kur subjekti nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta.

2. Subjektet krijojnë sistemin e administrimit të rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim miradministrimin e rrezikut të likuiditetit. Ky sistem përfshin minimalisht strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit, strukturën organizative të krijuar për administrimin e rrezikut të likuiditetit, sistemin e kontrollit të brendshëm, sistemin e administrimit të informacionit etj.

3. Subjektet sigurojnë që sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e subjektit, tipologjinë e veprimtarisë së tij dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.

4. Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtme:

a) raporti i aktiveve me maturitet të mbetur deri në një muaj ndaj detyrimeve me maturitet të mbetur njëmuajor, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);

b) raporti i aktiveve me maturitet të mbetur deri në tre muaj ndaj detyrimeve me maturitet të mbetur tremujor, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind).

Neni 10 **Normat e lejueshme për pozicionet e hapura valutore**

1. Pozicioni i hapur valutore në një valutë të caktuar, përfaqëson shumën ekuivalente në lekë të diferencës midis të drejtave dhe detyrimeve gjithsej të subjektit, në këtë valutë.

2. Subjektet nuk duhet të tejkalojnë në fund të çdo dite pune, normat e mëposhtme për pozicionet e hapura në valutë:

a) raporti i pozicionit të hapur valutore për një monedhë me kapitalin, nuk duhet të jetë më shumë se 20% (njëzet për qind); dhe

b) raporti i pozicionit të hapur valutore për të gjitha monedhat me kapitalin, nuk duhet të jetë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) e kapitalit.

KREU III **ADMINISTRIMI I RREZIKUT NË SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E KREDIDHËNIES**

NËNKREU I **EKSPOZIMI NDAJ RREZIKUT DHE KUFIZIMET**

Neni 11 **Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit**

1. Subjekti siguron nivele të mjaftueshme të kapitalit në funksion të një veprimtarie të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe të përmbushjes së detyrimeve të tij gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.

2. Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtme:

a) raporti i kapitalit me totalin e aktiveve, nuk duhet të jetë më pak se 5% (pesë për qind) në vitin e parë të veprimtarisë, 8% (tetë për qind) në vitin e dytë dhe 10% (dhjetë për qind) në vazhdim;

b) raporti i kapitalit me totalin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);

c) raporti i kapitalit me totalin e kredive me probleme (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind).

Neni 12

Ekspozimi ndaj rrezikut dhe kufizimet

1. Subjekti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, përcakton kriteret dhe harton metodat e procedurat për identifikimin dhe monitorimin e të gjitha rreziqeve, në përputhje me aktet e brendshme të subjektit dhe aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë.

2. Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut/qeve, siç përcaktohet në raportet e mëposhtme:

a) raporti i aktiveve të qëndrueshme (neto) mbi totalin e aktiveve, nuk duhet të jetë më shumë se 20% (njëzet për qind) në vitin e parë të veprimtarisë dhe më shumë se 10% (dhjetë për qind) mbas vitit të parë të veprimtarisë;

b) raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me detyrimet që shkaktojnë shpenzime, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);

c) raporti i kredisë me totalin e aktiveve të subjektit, nuk duhet të jetë më shumë se 95% (nëntëdhjetë e pesë për qind);

d) çdo investim në tituj, me përjashtim të investimeve në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe titujve të emetuar nga qeveritë dhe/ose bankat qendrore të vendeve të OECD, nuk duhet të tejkalojë 5% (pesë për qind) të kapitalit të subjektit;

e) totali i investimeve në tituj, me përjashtim të investimeve në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe titujve të emetuar nga qeveritë dhe/ose bankat qendrore të vendeve të OECD, nuk duhet të tejkalojë 40% (dyzetë për qind) të kapitalit të subjektit.

NËNKREU II

ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË KREDISË

Neni 13

Rreziku i kredisë

1. Subjektet financiare jobanka miratojnë dokumentet e strategjive, politikave, procedurave dhe rregullave të brendshme për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë dhe të aktiveve të tjera.

2. Dokumentet e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përmbajnë/përfshijnë minimalisht:

a) strategjinë e kreditimit sipas periudhave, duke përfshirë objektiva realiste në lidhje me zgjerimin e portofolit të kredisë, përbërjen e tij sipas sektorëve, sipas gjeografisë, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.;

b) politikat e normave të interesit, të afateve, të shlyerjeve dhe të madhësisë së kredive;

c) rregullat e vendosur për njohjen dhe analizën e kredimarrësit dhe/ose të garantuesit të kredisë;

d) procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e kredive, si edhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë;

e) politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, kufijtë e kredisë për një klient, përqendrimin e kredisë sipas sektorëve, monitorimin sipas objektit dhe llojit të kredisë, analizën e mospërputhjeve të ndjeshme mes portofolit të kredisë dhe burimeve të financimit të tij përsa i takon afateve dhe llojit të monedhës, në drejtim të vlerësimit të lidhjes mes



rrezikut të kredisë dhe rreziqeve të tjera (ndryshimi i kursit të këmbimit, ndryshimi i normës së interesit etj.);

f) procedurat për ndjekjen në vazhdimësi të mbarëvajtjes së kredive dhe identifikimin e tyre sipas grupeve të kredive me karakteristika të njëjta, për ndjekjen me përparësi të kredive me probleme, për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga kreditë, kriteret për ristrukturimin e kredive;

g) procedurat për vlerësimin e cilësisë së aktiveve të tjera, për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi i aktiveve, si dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së tyre.

3. Subjektet financiare jobanka ruajnë në dosje të veçanta, të gjithë dokumentacionin përkatës për kredimarrësit.

Neni 14

Klasifikimi i kredisë

1. Subjektet financiare jobanka të licencuara për ushtrimin e aktivitetit kredidhënës, bëjnë klasifikimin e kredisë të paktën një herë në tre muaj.

2. Subjektet financiare jobanka, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë dhe gjendjen financiare të kredimarrësit, i klasifikojnë kreditë, në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) “kredi standarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë, janë plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimitarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht, për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

b) “kredi në ndjekje”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit në të ardhmen,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht, për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

c) “kredi nënstandarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura, ose subjekti nuk disponon gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare të tij,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

d) “kredi të dyshimta”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve - kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti, dhe deklarimi i kredimarrësit “në paaftësi paguese/i falimentuar”, vlerësohet si një mundësi reale,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

e) “kredi të humbura”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose subjekti ka vepruar juridikisht dhe në mënyrë përfundimtare (është marrë vendimi i formës së prerë të gjykatës) për të realizuar procesin e ekzekutimit të kolateralit,

ii) kryegjësja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së kështit.

3. Subjektet, në rastin kur kushtet e klasifikimit të kredive, të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni plotësohen për kategori të ndryshme të klasifikimit të kredisë, klasifikojnë kredinë në kategorinë më të ulët.

4. Subjektet, për persona ose grup personash të lidhur, për të cilët është regjistruar më shumë se një ekspozim, bëjnë klasifikimin e kredive në një kategori të vetme, duke u bazuar në klasifikimin më të ulët ndërmjet klasifikimeve individuale.

Neni 15

Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit të kredive, subjektet financiare jobanka krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:

- a) për “kreditë standarde”1% (një për qind);
- b) për “kreditë në ndjekje”5% (pesë për qind);
- c) për “kreditë nënstandarde”jo më pak se 20% (njëzet për qind);
- d) për “kreditë e dyshimtë”jo më pak se 50% (pesëdhjetë për qind);
- e) për “kreditë e humbur”jo më pak se 100% (njëqind për qind).

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, për dy kategoritë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni, do të aplikohet njëllor si për kryegjës dhe interesin, ndërsa për kredinë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përlllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. Subjekti financiar jobankë nuk kontabilizon interesat e përlllogaritur, duke filluar nga momenti i klasifikimit të kredisë si kredi me probleme.

Neni 16

Ristrukturimi i kredisë

1. Subjektet, në marrëveshje me kredimarrësin, mund të ristrukturojnë kredinë sipas kriterëve të përcaktuara në manualin e kredisë, të miratuar nga organet drejtuese. Ristrukturimi i kredisë mund të kryhet dhe kur, mbështetur në analizat e tyre, subjektet gjykojnë se në të ardhmen gjendja financiare e kredimarrësit do të përmirësohet ndjeshëm, ose të ardhurat nga veprimtaria e tij do të rriten në mënyrë të konsiderueshme dhe kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë sipas kushteve të reja.

2. Kredia e ristrukturuar, nuk mund të klasifikohet më lart se një kategori nga kategoria në të cilën është klasifikuar përpara ristrukturimit dhe, në çdo rast, jo më lart se kategoria “nënstandard”, deri në plotësimin njëkohësisht të kushteve të mëposhtme:

- a) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt kështet (kryegjë dhe interes) për një periudhë prej 9 (nëntë) muajsh nga data e ristrukturimit;
- b) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 3 (tre) kështe (kryegjë dhe interes).

3. Kredia e ristrukturuar, me plotësimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, klasifikohet duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë kre.

Neni 17

Fshirja e kredive të humbura

1. Fshirja e kredive të humbura bëhet me vendim të organeve drejtuese të subjektit, si dhe në çdo rast kur Banka e Shqipërisë ka vlerësuar dhe kërkuar fshirjen e saj.



2. Dosjet e kredive të fshira, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj nga organi drejtues i subjektit financiar jobankë. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira, konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

NËNKREU III ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË KREDISË NË INSTITUCIONET FINANCIARE TË MIKROKREDISË

Neni 18

Klasifikimi i kredive për institucionet financiare të mikrokredisë

1. Institucionet financiare të mikrokredisë bëjnë klasifikimin e kredive, të paktën një herë në tre muaj.

2. Institucionet financiare të mikrokredisë, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë, i klasifikojnë ato në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) “kredi standarde”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga afati i maturitetit;

b) “kredi nënstandarde”, kur kryegjëja ose interesi, nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga afati i maturitetit;

c) “kredi të dyshimta”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga afati i maturitetit;

d) “kredi të humbura”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga afati i maturitetit.

3. Çdo kredi e dhënë për të ripaguar një kredi tjetër së cilës i ka kaluar afati dhe kushtet e së cilës janë modifikuar pjesërisht, në rastin e zgjatjes së afatit të kredisë, ose tërësisht si në rastin e ristrukturimit të kredisë për shkak të kushteve të vështira financiare të kredimarrësit apo paaftësisë së tij për të paguar, nuk duhet të klasifikohet në një kategori më të lartë se ajo nënstandarde.

4. Çdo kredi e dhënë në valutë të huaj klientëve të cilët nuk i kanë burimet e të ardhurave në valutë të huaj, nuk do të klasifikohet në një kategori më të lartë se kredia nënstandarde.

Neni 19

Llogaritja e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit të kredive, institucionet financiare të mikrokredisë krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:

a) për “kreditë standarde”1% (një për qind);

b) për “kreditë nënstandarde”jo më pak se 30% (tridhjetë për qind);

c) për “kreditë e dyshimta”jo më pak se 75% (shtatëdhjetë për qind);

d) për “kreditë e humbur”jo më pak se 100% (njëqind për qind).

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, për kategorinë “standarde”, do të aplikohet njëllor si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kreditë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. Institucionet financiare të mikrokredisë, nuk kontabilizojnë interesat e përllogaritur duke filluar nga momenti i klasifikimit të kredisë si kredi me probleme.

Neni 20

Fshirja e kredive të humbura

1. Institucioni financiar i mikrokredisë fshin kredinë nga bilanci kontabël, jo më vonë se tremujori i parë pasardhës, nëse ajo plotëson një nga kriteret e mëposhtme:

a) kredia është klasifikuar si kredi me probleme dhe institucioni financiar i mikrokredisë konstaton se kredimarrësi nuk do të mund të paguajë detyrimin që lidhet me kredinë;

b) kredimarrësi ka vdekur dhe nuk ka ndonjë trashëgimtar, garantues apo nënshkrues, i cili të mund të shlyejë detyrimin; ose

c) ripagimit (shlyerjes) të kryegjësë apo interesit të kredisë i ka kaluar afati 365 (treqind e pesëdhjetë) ditë;

d) kredia është vlerësuar si e humbur nga inspektorët e mbikëqyrjes dhe në raportin e inspektimit është kërkuar fshirja e saj.

2. Dosjet e kredive të fshira ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në gjashtë muaj nga organet drejtuese të institucionit financiar të mikrokredisë. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

KREU IV

ADMINISTRIMI I RREZKUT NË SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E QIRASË FINANCIARE

Neni 21

Ekspozimi maksimal i lejueshëm

1. Ekspozimi i subjektit që ushtron veprimtarinë e qirasë financiare ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, konsiderohet ekspozim i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 25% (njëzet e pesë për qind) e kapitalit të subjektit.

2. Subjekti nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat të marra së bashku, tejkalojnë 1200% (një mijë e dyqind) për qind të kapitalit të subjektit.

Neni 22

Klasifikimi i kontratave të qirasë financiare

1. Subjektet financiare jobanka të licencuara për ushtrimin e qirasë financiare, bëjnë klasifikimin e kontratave të qirasë financiare të paktën një herë në tre muaj.

2. Subjektet financiare jobanka, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kontratës së qirasë financiare, i klasifikojnë ato në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) “standarde”, kur kryegjësja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

b) “ndjekje”, kur kryegjësja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

c) “nënstandarde”, kur kryegjësja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

d) “të dyshimta”, kur kryegjësja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

e) “të humbura”, kur kryegjësja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së këstit.



Neni 23

Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kontratat e qirasë financiare

1. Subjektet, në varësi të kategorive të klasifikimit, krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga mospagimi i kontratave të qirasë financiare.
2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:
 - a) për “kategorinë standarde”1% (një për qind);
 - b) për “kategorinë në ndjekje”5% (pesë për qind);
 - c) për “kategorinë nënstandarde.....jo më pak se 20% (njëzet për qind);
 - d) për “kategorinë e dyshimtë”jo më pak se 20% (njëzet për qind);
 - e) për “kategorinë e humbur”jo më pak se 20% (njëzet për qind).
3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve për dy kategoritë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të paragrafit 2 të këtij neni, do të aplikohet njëllor si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kategoritë e përcaktuara në shkronjat “c”, “d” dhe “e”, norma e aplikuar mbi interesin e përlllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.
4. Subjektet nuk kontabilizojnë interesat e përlllogaritur, duke filluar nga momenti i klasifikimit të kontratës së qirasë në kategorinë nënstandarde.

KREU V

ADMINISTRIMI I RREZIKUT NË SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E FAKTORINGUT

Neni 24

Të përgjithshme

1. Transaksionet faktoring nuk mund të kryhen kur faktori dhe palët e përfshira (qoftë edhe njëra apo nga të dy palët) janë persona ose grup personash të lidhur me njëri tjetrin.
2. Faktori nuk mund të kryejë transaksione faktoringu me dy (2) persona ose grup personash të lidhur mes tyre në marrëdhënien furnizues – blerës.

Neni 25

Klasifikimi i kontratave faktoring

1. Subjektet bëjnë klasifikimin e kontratave faktoring të paktën një herë në tre muaj.
2. Subjektet i klasifikojnë kontratat faktoring, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e pagesës sipas datës (së pagesës) të përcaktuar në kushtet e kontratës faktoring, në një nga kategoritë e mëposhtme:
 - a) “standarde”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës;
 - b) “ndjekje”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës;
 - c) “nënstandarde”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës;
 - d) “të dyshimta”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës;
 - e) “të humbura”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës.

Neni 26

Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kontratat faktoring

1. Subjektet, në varësi të kategorive të klasifikimit, krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kontratat faktoring.
2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:
 - a) për “standarde”1% (një për qind);
 - b) për “në ndjekje”5% (pesë për qind);
 - c) për “nënstandarde”jo më pak se 20% (njëzet për qind);
 - d) për “e dyshimtë”jo më pak se 50% (pesëdhjetë për qind);
 - e) për “e humbur”jo më pak se 100% (njëqind për qind).
3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve për dy kategoritë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të paragrafit 2 të këtij neni, do të aplikohet njëllor si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kategoritë e përcaktuara në shkronjat “c”, “d” dhe “e”, norma e aplikuar mbi interesin e përlllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.
4. Subjektet nuk kontabilizojnë interesat e përlllogaritur, duke filluar nga momenti i klasifikimit të kontratës së faktoringut në kategorinë nënstandarde.

KREU VI

ADMINISTRIMI I RREZIKUT NË INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE

Neni 27

Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit

1. Institucioni i parasë elektronike, për ushtrimin e veprimtarisë së sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të tij gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, siguron nivele të mjaftueshme të kapitalit.
2. Institucioni i parasë elektronike respekton në çdo kohë treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtëm:
 - a) raporti i kapitalit ndaj tepricës mesatare të parasë elektronike në qarkullim nuk duhet të jetë më i vogël se 2% (dy për qind), në rastet e institucionit të parasë elektronike që ushtron vetëm veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike;
 - b) raporti i kapitalit ndaj shpenzimeve fikse të vitit paraardhës nuk duhet të jetë më i vogël se 10% (dhjetë për qind), në rastet e institucionit të parasë elektronike që ushtron dhe veprimtarinë financiare të shërbimit të pagesave dhe të transferimit të parave.
3. Në rastin e institucionit të parasë elektronike, i cili në datën e llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, respektivisht:
 - a) nuk ka mbushur gjashtë muaj në ushtrimin e aktivitetit të tij, raporti llogaritet mbi bazën e parashikimit të monedhës elektronike në qarkullim siç parashikohet në planin e biznesit, të paraqitur në procesin e aplikimit për marrjen e licencës së institucionit të parasë elektronike që ushtron vetëm veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike;
 - b) nuk ka mbushur 12 (dymbëdhjetë) muaj (1 vit) në ushtrimin e aktivitetit të tij, raporti llogaritet mbi bazën e shpenzimeve fikse të parashikuara në planin e biznesit të institucionit, të paraqitur në procesin e aplikimit për marrjen e licencës së institucionit të parasë elektronike që ushtron dhe veprimtarinë financiare të shërbimit të pagesave dhe të transferimit të parave.
4. Banka e Shqipërisë, bazuar në vlerësimin e sistemeve të administrimit të rrezikut, të të dhënave mbi rrezikun e humbjeve dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit, mund të kërkojë në çdo rast nivele shtesë kapitali deri në 20% (njëzet për qind) mbi nivelin e kapitalit fillestar minimal të kërkuar.



Neni 28

Sigurimi i fondeve të klientëve

1. Institucioni i parasë elektronike siguron që fondet e pranuar në këmbim të emetimit të parasë elektronike, të mbahen në një llogari kontabël të veçantë, të ndarë nga llogaritë e tjera të institucionit.

2. Institucioni i parasë elektronike, në rastet kur fondet e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk investohen në aktive likuide, i siguron këto fonde me polica sigurimi ose garanci të tjera të ngjashme të lëshuara nga shoqëri sigurimi ose nga banka, të cilat nuk i përkasin të njëjtit grup bankar/financiar, pjesë e të cilit mund të jetë institucioni i parasë elektronike.

Neni 29

Rreziku i likuiditetit

1. Institucioni i parasë elektronike siguron që niveli i aktiveve likuide të jetë në çdo rast minimalisht i barabartë me vlerën e fondeve të pranuar në këmbim të emetimit të parasë elektronike.

2. “Aktive likuide” të një institucioni që emeton para elektronike, për qëllime të zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni, do të konsiderohen:

a) llogaritë rrjedhëse dhe/ose depozitat me afat maturiteti të mbetur deri në 7 ditë dhe/ose depozitat pa afat, në një bankë ose degë të bankës së huaj;

b) bonot e thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në monedhën vendase ose të huaj, të regjistruar në bilanc si të tregtueshme ose të vendosjes;

c) llogaritë rrjedhëse dhe/ose depozitat me afat maturiteti të mbetur deri në 7 ditë dhe/ose depozitat pa afat në një bankë tregtare të huaj, e cila ka klasifikim (rating) mbi A+, sipas Standard&Poors ose të barasvlershëm me të;

d) tituj të borxhit të emtuar ose të garantuar nga qeveritë qendrore, nga bankat qendrore, institucionet ndërkombëtare ose banka shumëpalëshe të zhvillimit, klasifikimi (rating) për të cilët (kundërpartitë) sipas Standard&Poors, ose të barasvlefshtëm me të, është mbi A+, të regjistruar në bilanc si të tregtueshëm ose të vendosjes.

KREU VII

KËRKESA RAPORTUESE DHE MASAT MBIKËQYRËSE

Neni 30

Raportet financiare

1. Subjekti financiar jobankë mban llogaritë kontabël dhe përgatit raportet financiare për pasqyrimin e saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat kontabël të gjendjes së tij financiare, mbi baza individuale ose të konsoliduara.

2. Llogaritë kontabël dhe raportet financiare përgatiten në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Neni 31

Auditimi i ekspertit kontabël të autorizuar

1. Eksperti kontabël i autorizuar kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e raporteve financiare të subjektit financiar jobankë, me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

2. Eksperti kontabël i autorizuar kontrollon dhe vlerëson:
- a) llogarinë e humbje-fitimit (pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve);
 - b) bilancin kontabël;
 - c) raportin për ndryshimet në kapital;
 - d) pasqyrën e cash – flow;
 - e) zbatimin e politikave të fshirjes së zërave të bilancit;
 - f) raportet e konsoliduara;
 - g) funksionin e kontrollit të brendshëm;
 - h) regjistrimet kontabël;
 - i) sistemet e informacionit;
 - j) saktësinë dhe plotësimin e raporteve të paraqitura në Bankën e Shqipërisë;
 - k) mjaftueshmërinë e procedurave kontabël dhe zbatimin e rregulloreve;
 - l) shënimet që shoqërojnë raportet financiare.

Eksperti kontabël i autorizuar verifikon saktësinë e mbajtjes të llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare, përfshirë metodat e parashikuara nga Banka e Shqipërisë, si dhe përgatit një raport vjetor, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të subjektit financiar jobankë, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga subjekti, në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Neni 32

Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. Subjektet financiare jobanka raportojnë në Bankën e Shqipërisë sipas kërkesave të përcaktuara në “Sistemin raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”, të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

2. Subjektet financiare jobanka dërgojnë në Bankën e Shqipërisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, një kopje të raportit vjetor dhe të opinionit të ekspertit kontabël të autorizuar, ku pasqyrohet gjendja financiare dhe kontabël mbi baza individuale dhe të konsoliduara.

3. Subjektet financiare jobanka detyrohen të raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë, për çdo rast të ekspozimit të madh dhe/ose të tejkalimit të normave mbikëqyrëse të lejueshme, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë përcakton dhe njofton subjektin financiar jobankë për kohën dhe masat e nevojshme, me qëllim rivendosjen e ekspozimeve brenda kufizimeve maksimale të lejueshme.

Neni 33

Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse, parandaluese dhe ndëshkimore, të parashikuara në ligjin për bankat.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 34

Lista e vendeve anëtare të OECD, është lista më e fundit e publikuar nga kjo organizatë në faqen e saj zyrtare të internetit.



VENDIM
Nr. 3, datë 17.1.2013

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR INSTRUMENTET
E PAGESAVE ELEKTRONIKE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1 pika 4 shkronja “b”; nenit 21, nenit 43 shkronja “c” e ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për instrumentet e pagesave elektronike” miratuar me vendimin nr. 11, datë 06.02.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 3, pika 1, pas togfjalëshit “degët e bankave të huaja” shtohet togfjalëshi “si dhe institucionet e parasë elektronike, të licencuara nga Banka e Shqipërisë”;
 - b) Shkronjat “f”, “g”, “h” dhe “i” të nenit 4 shfuqizohen;
 - c) Shkronja “e” e nenit 4 ndryshon, me përmbajtje si më poshtë:
“Shërbime të tjera elektronike bankare – janë shërbimet bankare të realizuara online, të tilla si: home banking, të cilat mund të aksesohen nga klientët e subjekteve të kësaj rregulloreje, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të ndryshme të telekomunikacionit, si për shembull, telefoni, celulari, терминаlet ose kompjuterat personalë etj.”;
 - d) Shkronja “k” e nenit 4 ndryshon, me përmbajtje si më poshtë:
“Emetues – janë banka, dega e bankës së huaj ose institucioni i parasë elektronike, të cilët emetojnë IPE, sipas kontratës me mbajtësin e IPE-ve.”
 - e) Në nenin 7, pika 1, pas togfjalëshit “degët e bankave të huaja”, shtohet togfjalëshi “dhe institucionet e parasë elektronike”.
 - f) Paragrafi 1 i nenit 22 ndryshon, me përmbajtje si më poshtë:
“Shlyerja e pagesave në lekë/valutë me kartë bankare të emtuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, kryhet nëpërmjet shoqërive ndërkombëtare të kartave apo ofruesve lokalë të shërbimeve për pagesa, me karta dhe/ose bankave korrespondente të huaja, në përputhje me marrëveshjet dy ose shumëpalëshe, të lidhura ndërmjet emetuesit/pranuesit me shoqëritë e kartave apo me ofruesit lokalë të shërbimeve për pagesa me karta.”
 - g) Në nenin 22, paragrafi 2, pas togfjalëshit “me shoqëri ndërkombëtare të kartave” shtohet togfjalëshi “apo me ofruesit lokalë të shërbimeve për pagesa me karta”.
 - h) Neni 23 dhe 25 shfuqizohen.
 - i) Neni 26 ndryshon me përmbajtje, si më poshtë:
“1. Instrumentet e parasë elektronike mund të jenë në formën e:
 - a) kartave të parapaguara, të cilat paraqiten si karta plastike me fuqi blerëse; dhe
 - b) produkteve të parapaguara, të cilat konsistojnë në programe të veçanta, që i mundësojnë mbajtësit, transferimin e parasë elektronike nëpërmjet rrjeteve elektronike të komunikimit.
 2. Lista e instrumenteve të parasë elektronike të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nuk është shteruese dhe varet nga zhvillimet e mëtejshme të teknologjisë.”
 - j) Pas nenit 26, shtohet neni 26/1, me përmbajtje si më poshtë :

“Neni 26/1

Raste përjashtimore

Për qëllime të kësaj rregulloreje, nuk do të konsiderohet si para elektronike:

a) vlerat monetare që ruhen në instrumente të parapaguara, që përdoren me qëllimin për të përmbushur nevoja specifike të klientëve dhe që mund të përdoren në mënyrë të kufizuar sepse:

i) i japin mundësinë mbajtësit të blejë mallra dhe/ose shërbime të caktuara, të ofruara nga emetuesi vetëm në ambientet ku zhvillon veprimtarinë emetuesi i parasë elektronike ose brenda një rrjeti të përcaktuar ofruesish shërbimesh, subjekte të një marrëveshjeje tregtare me emetuesin e parasë elektronike (një dyqan i caktuar, zinxhir dyqanesh etj.); ose

ii) mund të përdoren për të blerë vetëm një numër të kufizuar mallrash dhe/ose shërbimesh.

b) vlera monetare që përdoret për të blerë mallra ose shërbime dixhitale dhe që përdoren vetëm nëpërmjet një pajisjeje dixhitale, të tillë si kompjuter dhe/ose telefon celular, për aq kohë sa operatori i komunikimeve elektronike, IT ose dixhital nuk luan vetëm rolin e një ndërmjetësi midis përdoruesit të shërbimit të pagesave dhe ofruesit të mallrave.”

k) Neni 27 ndryshon, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 27

Emetimi i parasë elektronike

1. Emetuesi i parasë elektronike emeton para elektronike për një vlerë të barabartë me vlerën nominale të fondeve të marra nga mbajtësi i parasë elektronike.

2. Mbajtësi i parasë elektronike është pronari i fondeve që pranohen nga emetuesi i parasë elektronike për emetimin e parasë elektronike.

3. Emetuesi i parasë elektronike dhe mbajtësi i parasë elektronike lidhin një kontratë me shkrim, me qëllim krijimin dhe rregullimin e marrëdhënies për emetimin e parasë elektronike.

4. Kontrata midis emetuesit të parasë elektronike dhe mbajtësit të parasë elektronike përcakton qartë dhe në formë të kuptueshme kushtet në lidhje me emetimin dhe ripagimin.

5. Kufijtë minimalë dhe maksimalë, brenda të cilëve emetohet para elektronike, përcaktohen në kontratën e emetimit të parasë elektronike, duke respektuar kufijtë e mëposhtëm:

a) në rastin e instrumenteve të parasë elektronike pa rimbushje, shuma maksimale e ruajtur nuk duhet të jetë më shumë se 35 000 lekë ose kundravlehtë e saj në monedhë të huaj;

b) në rastet e instrumenteve me rimbushje, kufiri maksimal i transaksioneve të kryera brenda një viti kalendarik, nuk duhet të tejkalojë 350 000 lekë ose kundravlehtë e saj në monedhë të huaj, me përjashtim të rastit kur mbajtësi i parasë elektronike ka kërkuar ripagim, sipas kushteve të parashikuara në nenin 31 të kësaj rregulloreje për një shumë prej 150 000 lekë ose më shumë.

6. Emetuesi i parasë elektronike informon mbajtësin e parasë elektronike, para nënshkrimit të kontratës, në përputhje me shkronjën “b”, pika 1, të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

7. Emetuesi i parasë elektronike ndalohet t’i paguajë interes ose ndonjë përfitim tjetër, mbajtësit të parasë elektronike, për periudhën gjatë së cilës ky i fundit mban paranë elektronike.”

l) Nenet 28 dhe 29 shfuqizohen.

m) Në nenin 30 fjala “shkatërrohet” zëvendësohet me togfjalëshin “asgjësohet nga emetuesi i parasë elektronike”.

n) Neni 31 ndryshon, me përmbajtje si më poshtë:



“Neni 31

Ripagimi i fondeve

1. Emetuesi i parasë elektronike, me kërkesë të mbajtësit të parasë elektronike, i ripaguan atij, në çdo moment, në vlerë nominale, vlerën monetare të parasë elektronike.

2. Ripagimi mund të jetë objekt i aplikimit të komisioneve, vetëm nëse këto të fundit parashikohen në kontratën midis palëve dhe vetëm në një nga rastet e mëposhtme:

a) ripagimi kërkohet përpara përfundimit të kontratës;

b) kontrata parashikon një datë për përfundimin e saj dhe mbajtësi i parasë elektronike e përfundon kontratën, para datës së përfundimit; ose

c) ripagimi për shumën e papërdorur, kërkohet pas më shumë se një viti, nga data e përfundimit të kontratës.

3. Në rastet kur mbajtësi i parasë elektronike kërkon ripagim, përpara përfundimit të kontratës, ai ka të drejtën të kërkojë ripagim të plotë ose të pjesshëm të parasë elektronike që zotëron.

4. Në rastet kur ripagimi kërkohet nga mbajtësi i parasë elektronike, një ose deri në një vit, pas datës së përfundimit të kontratës, emetuesi i parasë elektronike ripaguan totalin e vlerës monetare të parasë elektronike të mbartur.

5. Emetuesit e parasë elektronike, pavarësisht sa parashikohet në këtë nen, në rastet e një personi të ndryshëm nga individ (konsumatori), që pranon para elektronike, përcaktojnë të drejtën e ripagimit në marrëveshjen kontraktuale midis emetuesit të parasë elektronike dhe këtij personi.

6. Emetuesi është përgjegjës ndaj mbajtësit, në rastet kur, ky i fundit ka pësuar humbje ose dëmtim të parasë elektronike si pasojë e mosfunksionimit të pajisjes, së autorizuar nga emetuesi, për pranimin e instrumentit të parasë elektronike si mjet pagese.”

o) Pas nenit 31 shtohet neni 31/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 31/1

E drejta e mbajtësit për informim

1. Emetuesi informon mbajtësin mbi transaksionet e kryera me instrumentin e parasë elektronike si dhe mbi tepricën e fondeve të mbetura dhe të ruajtura në të.

2. Informacioni i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, vihet në dispozicion të mbajtësit me kërkesën e tij.”

p) Neni 32 ndryshohet, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 32

Humbja ose dëmtimi

Në rastet e verifikimit të humbjes ose dëmtimit të instrumentit të parasë elektronike, emetuesi i kthen mbajtësit fondet e mbetura, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën ndërmjet palëve.”

3. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

KËRKESË

Shtetasja Dhurata Koxhaj, e bija e Asbiut dhe e Lirisë, e datëlindjes 26.1.1993, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Armand Koxhaj, i datëlindjes 1970.

KËRKUESI
Dhurata Koxhaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 5.2.2013
Doli nga shtypi më 6.2.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 62 lekë